

Raporti Vjetor 2024



Shoqëria e Sigurimeve



PJESË E  KASTRATI GROUP

MISIONI DHE VIZIONI.....	5
PROFILI I SHOQËRISË.....	6
MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM.....	7
STRUKTURA QEVERISËSE.....	8
VEPRIMTARIA NË SIGURIMIN JO-JETË TË SHOQËRISË.....	9

1. Strategjia dhe politikat e menaxhimit të riskut

1.1. Sistemi i menaxhimit të riskut.....	10
1.2. Zhvillimet e tregut të sigurimeve.....	10
1.3. Faktorët kryesorë të riskut.....	11
1.4. Strategjitë për zbutjen e riskut.....	11
1.5. Plani i Menaxhimit të Riskut.....	11

2. Zhvillimet kryesore të aktivitetit të shoqërisë ALBSIG sha gjatë vitit 2024

2.1. Analiza SWOT për shoqërinë Albsig sh.a.....	13
--	----

3. Veprimtaria e Albsig për vitin 2024

3.1 Analiza institucionale e performancës dhe përcaktimi i objektivave për vitin 2024.....	14
3.2. Stafi i grave dhe vajzave të Albsig vizitë turistike në Selanik me rastin e festës së 8 Marsit.....	15
3.3. Albsig bëhet pjesë e eventit "Java e Filantropisë 2024".....	15
3.4. Albsig, promotor në edicionin e 6-të Panairit Ndërkombëtarë të Turizmit.....	16
3.5. Albsig, pjesmarrëse në panairin e punës në Fakultetin e Ekonomisë.....	16
3.6. Albsig, pjesë e panairit të organizuar nga Western Balkans University.....	17
3.7. Albsig – një dritare mundësish për të rinjtë në Panairin e Punës dhe Karrierës 2024, realizuar nga Fakulteti i Biznesit, UAMD.....	17
3.8. "Albsig Fan Zone", hapësirë dedikuar komunitetit në mbështetje të Kombëtares Shqiptare.....	18
3.9. Analiza 7-mujore e punës në Albsig: Performanca e suksesshme finaciare, reduktim i kostove dhe zgjidhja e shpejtë e kërkesave të klientëve. Albsig shpërblen punonjësit.....	19
3.10. Albsig, trajnim të dedikuar për sigurimin e Paneleve Fotovoltaike.....	19
3.11. Panairi "Karta e Studentit": Një mundësi e re nga Albsig për studentët.....	20

4. Përgjegjësia Sociale e Albsig për vitin 2024

4.1. Hyrje.....	21
4.2. Një ditë në Albsig, Iden pjesë e projektit "Drejtues për një ditë" nga Junior Achievement of Albania.....	21
4.3. Albsig: Festa e 1 Qershorit me fëmijët e stafit në bregdetin e Durrësit.....	22
4.4. Albsig mbështet trupën e Portokallisë në Serialin e Verës, "Verë dhe Portokalle".....	23
4.5. Shkolla "Santa Marcellina" në Sarandë, 12 vite përkushtim për Sigurimin e Nxënësve në Albsig.....	23
4.6. Albsig dhe Qendra për Edukim Kulinar: Një Ditë Gatimi Plot Dashuri për Fëmijët në Nevojë.....	24
4.7. Albsig dhe Kastrati Construction ofrojnë vizita falas për gratë dhe vajzat e stafit në kuadër të Tetorit Rozë në Turkish Hospital.....	26
4.8. Albsig merr pjesë në "Ping Pong Business Tournament" dhe promovon rëndësinë e sportit në komunitetin e biznesit.....	27
4.9. Albsig Investon në veshje për fëmijët me aftësi ndryshe në qendrën "Zëra Jete" në Elbasan.....	27

5. Auditimi i brendshëm

5.1 Objektivi dhe qëllimi i Auditimit të Brendshëm.....	29
5.2 Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm.....	29
5.3 Pohimi për pavarësinë.....	29
5.4 Struktura organizative dhe raportimi.....	30
5.5 Opinioni i Audituesit të Brendshëm.....	30

6. Përmbushja e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut	
6.1. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve.....	31
6.2 Vlerësimi i risqeve	31
6.3 Kornizimi i riskut i shoqërisë Albsig Sh.a	32
6.4 Dëmet në shoqërinë Albsig Sh.a.....	34
6.5 Kuadri i Administrimit të Riskut	36
6.6 Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese	36
6.7 Aktive në mbulim të provigjoneve teknike	36
6.8 Marzhi i Aftësisë Paguese	37
6.9 Testi i rezultateve të marrjes në sigurim.....	40
6.10. Toleranca dhe kufijtë e riskut	41
6.11. Kufijtë për risigurim 2024	41
7. Kuadri i raportimit	
7.1 Kontrollët e brendshme	42
7.2. Ngritja e reputacionit për të zgjeruar bazën konkuruese.....	43
8. Skenarët e stress-testeve	
8.1 Vetëvlerësimi i riskut, ORSA	44
8.2 Teste të paralajmërimit të hershëm	45
8.3. Planet e vazhdueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara.....	46
9. Raporti i audituesit të pavarur	
9.1 Opinioni i Auditorit të Jashtëm.....	47
9.2. Pasqyra individuale e pozicionit financiar.....	50
9.3. Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse.....	51
9.4. Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital	52
9.5. Pasqyra individuale e flukseve monetare	53
9.6. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale.....	54
10. Objektivat strategjike dhe vjetore	
10.1 Objektivat strategjike dhe vjetore	57



ALBSIG



**PJESË E
KASTRATI GROUP**

Raporti vjetor i shoqërisë Albsig sh.a. për vitin 2024

Bulevardi Bajram Curri, Albsig HQ, Kati 16&17, 1010 – Tirana, Albania

+355 (0) 44502060 / +355 (0) 42254770

info@albsig.al

E drejta e autorit © 2024

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohen, të ruhen në një sistem rikthimi.

MISIONI DHE VIZIONI



MISIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.



VIZIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.



FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



PROFILI I SHOQËRISË

→	Emri i Shoqërisë:	ALBSIG sh.a.
→	Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:	Z. Shefqet Kastrati Z. Arben Breshani
→	Drejtor i Përgjithshëm:	Z. Muharrem BARDHOCI
→	Lokalizimi i zyrave qendrore:	Bulevardi Bajram Curri, Albsig HQ, Kati 16&17, 1010 - Tirana, Albania
→	Data e themelimit:	09 / 01 / 2004
→	Kapitali themeltar:	879,460,000 lekë
→	Numri i punonjësve:	250
→	Aktiviteti:	Në cilësinë e siguruesit të (Jo-Jetës)
→	Tel:	+355 4 22 54 770 +355 4 22 54 76
→	Website:	www.albsig.al
→	Kontakt:	info@albsig.al



MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar klientë dhe bashkëpunëtorë!

Ndryshimet e mëdha që po përjeton bota karakterizohen nga pasiguri në rritje, sfida të ndërlikuara dhe rreziqe gjithnjë e më të paparashikueshme. Tensionet gjeopolitike, vështirësitë ekonomike dhe krizat mjedisore kanë krijuar një realitet të ri, që kërkon vigjilencë dhe përshtatje të vazhdueshme.

Në këtë kontekst sfidues, shoqëria Albsig sh.a. ka dëshmuar aftësinë për të ruajtur stabilitetin dhe për të vijuar rritjen. Ne kemi kapërcyer me sukses situata të jashtëzakonshme, nga fatkeqësitë natyrore dhe krizat financiare, deri te pandemia, duke qëndruar gjithmonë pranë klientëve dhe duke përmbushur angazhimet tona.



Qëndrueshmëria dhe sukcesi afatgjatë varen nga aftësia për të reaguar me efikasitet dhe për të përshtatur veprimtarinë sipas kushteve të reja. Në Albsig, ne investojmë vazhdimisht në ndërtimin e kapaciteteve të brendshme, në zhvillimin e stafit tonë dhe në forcimin e marrëdhënieve me partnerët tanë strategjikë.

Angazhimi ynë mbetet i palëkundur, të ofrojmë siguri dhe besueshmëri për klientët tanë dhe të kontribuojmë në sigurinë e komuniteteve që i shërbejmë. Nëpërmjet ekspertizës në menaxhimin e riskut dhe bashkëpunimit të ngushtë me institucionet përkatëse, synojmë të promovojmë dhe të nxisim një kulturë përgjegjshmërie të përbashkët.

Besimi që klientët tanë kanë treguar ndër vite është vlerë e jashtëzakonshme për ne. Në periudha pasigurie, një gjë mbetet e sigurt, Albsig do të jetë gjithmonë këtu për t'ju mbështetur, për t'ju orientuar dhe për të qenë një partner i besueshëm në çdo hap.

Faleminderit për mbështetjen e vazhdueshme.

Me respekt,
Muharrem Bardhoci



QEVERISJA E SHOQËRISË ALBSIG SH.A.

● Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve

Shoqëria ALBSIG sh.a. është në pronësi të 1 aksionari

Z. Shefqet Kastrati 100 %

● Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës:

Z. Shefqet Kastrati

Z. Arben Breshani

● Komitetet

1. Komiteti i Administrimit të Riskut

2. Komiteti i Auditimit të brendshëm

● Drejtor i Përgjithshëm

Z. Muharrem Bardhoci

● Departamentet / Degët

ALBSIG është i organizuar në 7 Departamente.

ALBSIG ka 25 degë, të vendosura në çdo qytet në Shqipëri.

Numri i të punësuarve është 250.

● Kapitali i nënshkruar

Kapitali i paguar i shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 është 879,460 mijë Lekë

Kapitali së bashku me fitimin e mbartur me 2024 është 21.4 (milion euro).



Albsig sh.a. është themeluar në vitin 2004 si një shoqëri sigurimi me seli në Tiranë. Shoqëria është një shoqëri aksionare me kapital të përbashkët, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, Nr. 28154, datë 9 janar 2004, dhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numer identifikimi K42108801C.

Shoqëria operon sipas liçensës të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare, për të ushtruar veprimtari sigurimi sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jo-jetës është marrë më datë 19 qershor 2004, ndërsa liçensa që specifikon klasat e aktiviteteve është lëshuar më datë 10 shtator 2004 nga AMF

Liçenca i jep të drejtën Shoqërisë së Sigurimeve Albsig Sh.a. e kryerjes së operacioneve të sigurimit në cilësinë e operatorit të Jo-Jetës sipas grupeve të sigurimit të listuara më poshtë:

- Grupi nr. 1 "Aksidente"
- Grupi nr. 2 "Sëmundjet"
- Grupi nr. 3 "Mjete tokësore" (të ndryshme nga ato që lëvizin mbi shina)
- Grupi nr. 4 "Mjete lëvizëse mbi shina"
- Grupi nr. 5 "Avionët"
- Grupi nr. 6 "Anijet"
- Grupi nr. 7 "Mallrat në transport"
- Grupi nr. 8 "Zjarri dhe forcat e natyrës"
- Grupi nr. 9 "Dëmtime të tjera të pasurisë"
- Grupi nr. 10 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i automjeteve"
- Grupi nr. 11 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i avionëve"
- Grupi nr. 12 "Përgjegjësitë civile nga përdorimi i anijeve"
- Grupi nr. 13 "Përgjegjësitë civile të përgjithshme"
- Grupi nr. 14 "Sigurimi i kreditit" Licencimin e shoqërisë së sigurimit të Jo-Jetës Albsig sh.a., për zgjerimin e ushtrimit të veprimtarisë në klasën e 14-të të sigurimit. Me vendim nr. 21, datë 27.02.2020.
- Grupi nr. 15 "Garancitë"

1.1. Sistemi i menaxhimit të riskut:

- Përbën strategji, procese dhe procedura raportimi të nevojshme për të identifikuar, matur, menaxhuar dhe raportuar në mënyrë të vazhdueshme risqet, në një individ dhe në një nivel të agreguar, të cilat janë ose mund të jenë të ekspozuar, si dhe ndërvarësitë e tyre.
- Integrohet në strukturën organizative dhe në proceset e vendimit.
- Mbulon risqet që duhet të përfshihen në llogaritjen e RKS, si dhe risqet që nuk janë të përfshira plotësisht në llogaritjen SCR.

Ky raport përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në shoqërinë Albsig Sh.a., metodën sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e shoqërisë Albsig Sh.a. me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Shoqëria Albsig Sh.a. në muajin Dhjetor 2024 në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës miratoi projektplanet për vitin 2025. Këto plane ndihmojnë në ecurinë e shoqërisë dhe në ndërtimet e standarteve për shoqërinë Albsig sh.a.. Në planin e biznesit për vitin 2025 u përcaktua dhe ambicja e shoqërisë Albsig sh.a., (risku i oreksit) për arritjet e pritshme për tu realizuar për vitin 2025. Referuar këtij plani u përpilua dhe plani i Menaxhimit të Riskut për vitin 2025.

**1.2. Zhvillimet e tregut të sigurimeve**

Tregu i sigurimeve vazhdoi të rritet në mënyrë të qëndrueshme në vitin 2024, i nxitur nga rritja e kërkesës për produkte të ndryshme sigurimesh nëpër sektorë të ndryshëm. Megjithatë, normat e vazhdueshme të ulëta të interesit, pritshmëritë në zhvillim të klientëve, ndërprerjet teknologjike dhe pasiguritë gjeopolitike parashtruan sfida të rëndësishme.

1.3. Faktorët kryesorë të riskut

- a. **Rreziqet e nënshkrimit:** Lohatjet në frekuencën dhe ashpërsinë e dëmeve, përzgjedhja e pafavorshme dhe modelet e pasakta të çmimeve.
- b. **Rreziqet e tregut:** Paqëndrueshmëria në tregjet financiare, duke përfshirë lohatjet në vlerat e aktiveve dhe normat e interesit.
- c. **Rreziqet operacionale:** Kërcënimet e sigurisë kibernetike, ndërprerjet operacionale dhe kontrollet e brendshme joadekuate.
- d. **Rreziqet e reputacionit:** Publiciteti negativ, pakënaqësia e klientëve dhe dështimet e pajtueshmërisë.
- e. **Rreziqet rregullatore:** Ndryshimet në kërkesat rregullatore dhe kostot e pajtueshmërisë.
- f. **Rreziqet klimatike dhe katastrofike:** Rritja e shpeshtësisë dhe ashpërsisë së fatkeqësive natyrore, rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike.

1.4. Strategjitë për zbutjen e riskut

- a. **Disiplina e nënshkrimit:** Zbatimi i standardeve rigorozë të nënshkrimit, shfrytëzimi i analitikës së të dhënave për vlerësimin e rrezikut dhe diversifikimi i portofoleve të nënshkrimit.
- b. **Menaxhimi i detyrimeve të aktiveve:** Strategji të kujdesshme investimi, diversifikimi i portofoleve të investimeve dhe testimi i stresit.
- c. **Rezistenca Operacionale:** Rritja e masave të sigurisë kibernetike, planifikimi i vazhdimësisë së biznesit dhe investimi në infrastrukturën teknologjike.
- d. **Menaxhimi i reputacionit:** Komunikimi proaktiv, angazhimi i palëve të interesuara dhe mekanizma të fuqishëm të trajtimit të ankesave.
- e. **Pajtueshmëria rregullatore:** Monitorim i rregullt i zhvillimeve rregullatore, korniza të qëndrueshme të pajtueshmërisë dhe angazhim proaktiv me rregullatorët.
- f. **Menaxhimi i Riskut Klimatik:** Përfshirja e modelimit të riskut klimatik në vendimet e sigurimit dhe investimeve, promovimi i praktikave të qëndrueshme dhe mbështetja e iniciativave për elasticitetin e klimës.
- g. **Pajtueshmëria rregullatore:** Pajtueshmëria me kërkesat rregullatore mbeti një prioritet kryesor për shoqëritë e sigurimeve në vitin 2023. Kompanitë vazhduan të përshtateshin me kornizat rregullatore në zhvillim, duke përfshirë Solvency II, SNRF 17, GDPR dhe kërkesa të tjera.

1.5. Plani i Menaxhimit të Riskut

Plani i menaxhimit të riskut duhet të adresojë risqet që vijnë nga dështimi i funksionimit dhe sigurisë. Plani i menaxhimit të riskut kërkon që çdo organizatë të rishikojë strategjitë e menaxhimit të riskut dhe të zgjedhin masat e transferimit të riskut si përfitimi, mbulimi i sigurimeve etj. Masat e administrimit të miratuara dhe praktikave të sigurimit të ndjekura do të ndihmojnë për të menaxhuar riskun në mënyrë efektive dhe fitimprurëse. Plani përfshin objektivat përkatëse, parimet kryesore dhe shpërndarjen e duhur të përgjegjësisë për të trajtuar riskun në të gjithë veprimtarinë dhe njësitë organizative të shoqërisë së sigurimit, përfshirë edhe degët e saj.

“Menaxhimi i Riskut është Identifikimi, analiza dhe kontrolli i këtyre risqeve që mund të kërcënojnë pasuritë (prona, njerëzit) ose parametrat financiar të një shoqërie.

Parimet e menaxhimit të riskut mbështesin qasjen e menaxhimit të riskut për të udhëhequr mirëmbajtjen dhe zhvillimin e strukturës së administrimit të riskut. Shembujt përfshijnë relacione të qeverisjes së riskut të shoqërisë, pronësisë së riskut dhe kulturës së riskut.



Një nga sfidat kryesore për Albsig ishte rritja e konkurrencës në tregun e sigurimeve jo-jetë, e cila solli presion mbi marzhin e tyre të fitimit. Për të përballuar këtë sfidë, Albsig përdori strategji të menaxhimit të riskut të përshtatura, duke përdorur analiza të avancuara të të dhënave për të përmirësuar vlerësimin e riskut dhe për të optimizuar portofolin e marrjes në sigurim. Gjithashtu, ndryshimet teknologjike në treg solli nevojën për Albsig për të investuar në platforma dhe mjetet e reja të teknologjisë informative për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe për të rritur efikasitetin e tyre operacional.

Për të përshtatur me këtë tendencë, Albsig zhvilloi aplikacione mobile dhe platforma online për të lehtësuar blerjen dhe menaxhimin e politikave të sigurimeve për klientët e tyre. Në një mjedis ku kërkesat e konsumatorëve për transparencë dhe përputhshmëri janë në rritje, Albsig u përqendrua në ofrimin e një përvojë të klientit të përshtatshme dhe në përmirësimin e proceseve të tyre për menaxhimin e pretendimeve dhe komunikimin me klientët. Këto përpjekje kanë ndihmuar Albsig në ruajtjen dhe rritjen e besimit dhe lojalitetit të klientëve në tregun e sigurimeve jo-jetë në Shqipëri.

Aktiviteti i shoqërisë edhe për vitin 2024 vlerësohet shumë pozitiv dhe i suksesshëm. Bilanci i shoqërisë rezulton me fitim. Veprimtaria ekonomiko-financiare e vitit 2024 çoi në konsolidimin e mëtijshëm të shoqërisë. Albsig Sh.a. që përfaqëson një subjekt të konsoliduar, konform të gjitha standarteve dhe kërkesave të akteve ligjore e nënligjore. Aktiviteti ekonomik përgjatë vitit 2024 ka shënuar progres të ndjeshëm. Është rritur prezenca e Albsig sh.a. në tregun e sigurimeve.

ALBSIG SH.A. mbyll vitin 2024 në nivele të kënaqshme duke ruajtur raportin e vullnetareve në nivelin 53.07 % më të lartë në treg dhe rritjen me veten me 5.44 %.

- ▶ ALBSIG SH.A. renditet i 2-ti në treg duke zënë 19.23% të tregut jo jetë, me rritjen me veten me 5.44 %, ndërkohë që tregu e ka rritjen 6.66%.
- ▶ ALBSIG SH.A. ka raportin më të lartë për produktet vullnetare 53.07 %, ndërkohë që tregu e ka 32.85%.
- ▶ ALBSIG SH.A. ka numrin më të vogël të dëmeve pezull (të papaguara) në 31.12.2024, cfarë evidenton pagesën në kohë rekord të dëmeve në zbatim dhe të kërkesave ligjore.
- ▶ ALBSIG SH.A. rendit i pari në produktet Kasko, Përgjegjësi, Përgjegjësi Ndërtuesi dhe Garanci.

Shoqëria Albsig Sh.a. edhe gjatë vitit 2024 është pozicionuar në vend të dytë në tregun e sigurimeve jo — jetë si rrjedhojë e një pune të vazhdueshme në vite shumë rezultative në linjat e produkteve vullnetare sidomos të Pronës, Përgjegjësi në vecanti Përgjegjësi e Ndërtuesit, Garancive, në produktin Kasko, Portofoli “Aksidente dhe Shëndet”.

Shoqëria, për vitin 2024 si dhe në vitet paraardhëse vazhdon të renditet e para në tregun e sigurimeve për produktin Kasko, Përgjegjësi dhe Garancitë, e dyta për sigurimet vullnetare duke patur raportin më të lartë në treg 53.07 % dhe tek produkti Zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë (Zjarri, Vjedhja dhe Sigurimi Inxhinierik).

- Për linjat e detyrueshme motorike, prezenca në treg për vitin 2024 është 13.44 % nga 13.43 % në 2023.
- Për sigurimet vullnetare, prezenca në treg për vitin 2024 është 31.08 % nga 31.43 % në vitin 2023 duke u pozicionuar në vend të dytë.
- Shoqëria Albsig sh.a. gjatë vitit 2024 në treg zë 16.22% të dëmeve të paguara bruto.



2.1 Analizë SWOT për shoqërinë Albsig sh.a..

Shoqëria Albsig sh.a. duhet të shqyrtojë forcën dhe dobësinë e brendshme të saj, si dhe mundësitë dhe rreziqet që ndikojnë në mjedisin e jashtëm ku operon. Këtu janë disa elementë që mund të përfshihen në analizën SWOT për Albsig:

Forcat:

1. **Përvoja dhe Historia e Suksesit:** Shoqëria Albsig sh.a. mund të bazohet në një histori të gjatë të suksesit dhe përvojës në tregun e sigurimeve në Shqipëri prej 20 vitesh në treg.
2. **Përqëndrimi në Klient:** Përfaqësimi i mirë i klientëve dhe fokusi në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të personalizuar ndihmon në rritjen e besimit të klientëve.
3. **Partneritetet Strategjike:** Partneritetet e mira të ndërtuara me shoqëritë e tjera dhe institucione në treg si dhe Kastrati grup ofron avantazhe konkurruese dhe mundësi të reja biznesi.

Dobësitë:

1. **Mungesa e Inovacionit:** Nëse Albsig nuk investon në inovacion dhe zhvillim të produkteve dhe shërbimeve, mund të mbetet prapa në një treg që ndryshon me shpejtësi.
2. **Ndikimi i Imazhit të Markës:** Nëse imazhi i markës së Albsig është i dëmtuar për shkak të përvojave negative të klientëve ose raporteve të ulëta të shërbimeve, kjo mund të ndikojë negativisht në perceptimin e publikut dhe besueshmërinë e shoqërisë.
3. **Konkurrenca e Rritur:** Rritja e konkurrencës në tregun e sigurimeve mund të zvogëlojë marzhin e fitimit dhe të shtojë presionin për rritjen e cilësisë dhe shërbimeve për të mbajtur klientët ekzistues dhe të tërhequr të tjerët.

Mundësitë:

1. **Zhvillimi i Tregut të Sigurimeve:** Rritja e tregut të sigurimeve në Shqipëri, si dhe zgjerimi i nevojave për sigurime në sektorë të ndryshëm, mund të ofrojë mundësi rritjeje dhe zgjerimi për Albsig.
1. **Inovacioni Teknologjik:** Përdorimi i teknologjisë së re dhe zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të bazuar në teknologji mund të çojë në diferencimin e Albsig dhe në rritjen e konkurrencës në treg.
2. **Partneritetet e Reja dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar:** Partneritetet e reja me kompani të tjera dhe institucione ndërkombëtare mund të hapin dyer për tregje të reja dhe të ofrojnë mundësi të reja për zhvillim dhe rritje për Albsig.

Rreziqet:

1. **Ndryshimet e Ligjeve dhe Regulloreve:** Ndryshimet e ligjeve dhe rregullores mund të krijojnë kosto shtesë dhe rreziqe ligjore për Albsig, duke e vështirësuar zbatimin e operacioneve dhe duke kufizuar rritjen.
2. **Rreziku i Ngjarjeve të Papritura:** Ngjarjet e papritura si katastrofat natyrore ose ngjarje të tjera jashtëzakonisht mund të shkaktojnë kosto të mëdha për shoqërinë dhe të ulin performancën financiare.
3. **Ndryshimet në Preferencat e Konsumatorit:** Ndryshimet në preferencat dhe nevojat e konsumatorëve mund të sjellin sfida në rritjen dhe mbajtjen e bazës së klientëve për Albsig.

Gjatë vitit 2024, Shoqëria e Sigurimeve Albsig sh.a. ka dëshmuar një performancë të qëndrueshme dhe konkurruese në tregun shqiptar të sigurimeve, duke konsoliduar pozicionin e saj si një prej aktorëve kryesorë të këtij sektori. Si pjesë e Kastrati Group, Albsig ka qenë aktive në një sërë iniciativash profesionale, trajnimesh dhe veprimtarish institucionale, me qëllim forcimin e kapaciteteve të saj të brendshme dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientit. Në përmbushje të misionit të saj dhe të pritshmërive të klientëve, Shoqëria ka demonstruar një angazhim të lartë në trajtimin efikas dhe transparent të dëmeve, duke realizuar dëmshpërblime të konsiderueshme brenda afateve optimale.

Në të njëjtën kohë, Albsig ka vijuar të zgjerojë gamën e produkteve dhe shërbimeve të sigurimit, me fokus të veçantë në sigurimin e pronës, sigurimin e mjeteve motorike, sigurimet e përgjegjësi dhe ato të dedikuara për bizneset. Mbulimet e ofruara arrijnë në vlera të larta në miliona euro, duke garantuar siguri financiare për klientët në përputhje me standardet më të avancuara të tregut. Rrjeti i gjerë i shpërndarjes, me 25 degë aktive në të gjithë territorin e Shqipërisë, mbështet ofrimin e shërbimeve të personalizuar, efikase dhe të orientuara drejt nevojave të klientit. Investimet e vazhdueshme në teknologji, trajnime dhe përmirësim të proceseve kanë bërë që Albsig të afirmohet si lider në segmentin e sigurimeve vullnetare dhe në ofrimin e dëmshpërblimeve në kohë rekord.

3.1 Analiza institucionale e performancës dhe përcaktimi i objektivave për vitin 2024.

Në muajin shkurt 2024, Albsig realizoi një analizë të thelluar të aktivitetit të saj gjatë vitit 2023, si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm për përmirësimin e brendshëm, transparencën dhe orientimin strategjik. Kjo analizë përfshiu të gjitha strukturat e Shoqërisë, duke nisur nga Drejtoria e Përgjithshme, departamentet funksionale dhe degët në nivel vendor, si dhe shoqëritë simotra Albsig Jetë dhe Albsig Invest. Gjatë këtij procesi, u shqyrtuan rezultatet e arritura në përmbushjen e objektivave të vendosura për vitin që lamë pas, u identifikuan sfidat e hasura në operim dhe u formuluan propozime konkrete për përmirësim në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve dhe eficiencës operacionale.

Analiza shërbeu gjithashtu si bazë për përcaktimin e objektivave të reja për vitin 2024, duke ndihmuar në hartimin e një plani pune më të fokusuar dhe të matshëm për çdo njësi organizative. Ky proces u zhvillua në mënyrë të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet niveleve drejtuese dhe operacionale të Shoqërisë. Vlerësimi i rregullt i performancës dhe përcaktimi i objektivave përbëjnë një element kyç të kulturës së menaxhimit në Albsig, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përmbushjes së misionit për të ofruar siguri të qëndrueshme dhe cilësore për klientët dhe partnerët tanë.





3.2. Stafi i grave dhe vajzave të Albsig vizitë turistike në Selanik me rastin e festës së 8 Marsit.

Festa e 8 Marsit ka mbledhur bashkë gjithë stafin e grave dhe vajzave të Albsig, në një fundjavë turistike në Selanik. I gjithë stafi i grave dhe vajzave të Albsig, janë organizuar pikërisht në fundjavën e festës së 8-marsit dhe kanë realizuar turin e shkurtër. Nisja ka vijuar në mëngjes herët drejt pikës kufitare të Kapshticës.

Ndalesat rrugës për pushimin e mëngjesit. Vazhdimi i rrugës drejt kufirit ka qenë shumë harmonik dhe i gëzuar mes këngëve e valleve mes kolektivit. Përfundimi i procedurave kufitare dhe doganore dhe më pas mbërritja në Selanik rreth orës 17.00. Akomodimi nëpër dhoma, darka në hotel dhe koha e lirë për argëtim ka qenë e mbushur plot e për plot me vizita e shëtitje. Është e disata herë që stafi i grave dhe vajzave të Albsig me rastin e festës së 8 Marsit organizon ture të tilla.

Ne, në Albsig besojmë se "Klienti është mbret" dhe "stafi është i shenjtë" për këtë edhe shërbimi i mirë vjen nga marrëdhëniet e forta që krijohen tek ekipi ynë, nga përkushtimi i çdo dite për të dhënë më të mirën dhe nga fryma e përfshirjes dhe solidaritetit me klientët.



3.3. Albsig bëhet pjesë e eventit "Java e Filantropisë 2024"

Albsig bëhet pjesë e eventit të zhvilluar nga Partners Albania në kuadër të Javës së Filantropisë për vitin 2024 NPO-Business Speed Dating. Për të 8-in vit radhazi është organizuar event i me titull "Krijimi i Partneritetit Efektiv mes Shoqërisë Civile dhe Biznesit", ku këtë vit morën pjesë 70 biznese përfaqësues të sektorëve të ndryshme, si dhe OJF nga i gjithë vendi.

Albsig ishte një nga bizneset pjesëmarrëse ku, në stendën e saj të prezantimit priti një numër të konsiderueshëm OJF dhe biznesesh pjesëmarrëse në këtë event. Sipas përfaqësuesve të Albsig, pjesëmarrës në event, kontakti me OJF-të ishte i mbushur me eksperiencë dhe informacione të reja mbi veprimtarinë e tyre të aktivitetit. Jo vetëm kaq, por Albsig gjithmonë është dhe do të jetë në mbështetje të iniciativave suportuese ndaj organizatave jofitimprurëse.


Ndryshe nga vitet e tjera ky eveniment ishte ideuar e dizajnuar në mënyrë të tillë për t'u ardhur në ndihmë të gjithë bizneseve dhe OJF pjesëmarrëse në eveniment. Dhe jo vetëm kaq, por event i organizuar në përmbylljen e një serie aktivitetesh në kuadër

të Javës së filantropisë pati edhe një konkurs pikturë ku aktivistë dhe të rinjë nga më shumë së pesë qytete prezantuan përmes artit, konceptin e tyre mbi solidaritetin e filantropinë. Albsig ka qenë dhe do të mbetet një ndër promotorët dhe mbështetëset e startup-eve të reja. Numërohen me dhjetra biznese të vogla ku Albsig i ka mbështetur në fuqizimin e tyre.

3.4. Albsig, promotor në edicionin e 6-të Panairit Ndërkombëtarë të Turizmit

Muaji prill ka startuar duke hapur siparin e panairove të shumta në kryeqytet. Një ndër to dhe jo më pak i rëndësishmi ishte Panairi Ndërkombëtarë i Turizmit i cili, ndryshe nga herët e tjera këtë edicion të gjashtë e ka realizuar në qendër të Tiranës në një nga sheshet më të frekuentuara nga konsumatorët, në Sheshin Italia. Në edicionin e 6-të të Panairit Ndërkombëtar të Turizmit, mori pjesë dhe Albsig, ku përmes standave komunikuese, konsumatorët përfituan një prezantim ndryshe nga ana e kompanive pjesmarrëse.

Përveç standës më fletëpalosje me prezantime të shoqërive u përfitua nga ky rast për të ndarë me pjesëmarrësit një eksperiencë ndryshe. Komunikimi i drejtpërdrejtë me konsumatorët pjesmarrës në këtë eveniment ka qenë një ndër çështjet më të rëndësishme të eventit.



3.5. Albsig, pjesmarrëse në panairin e punës në Fakultetin e Ekonomisë

Albsig gjithmonë do të jetë promotore dhe mbështetëse e studentëve. Këtë herë ka qenë sërish një ndër subjektet pjesëmarrëse në Panairin e Punës organizuar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, i cili vazhdon të mbetet një traditë shumëvjeçare e suksesshme. Tashmë e kthyer në një traditë të përvitshme Albsig është pjesë e pandashme e eventit të kthyer në një platformë shumë

të mirë ndërlidhjeje për studentët me mundësitë e punësimit dhe zhvillimit të karrierës, të ofruara nga mbi 60 kompani të mëdha të pranishme, përfshirë sektorët kryesorë të ekonomisë si konsulenca, bankat, sigurimet, prodhimi, teknologjia, telekomunikacioni, etj.



Stenda e Albsig spikati me numrin e madh të vizitorëve. Albsig numëron shumë vite që është bërë pjesë mbështetëse dhe promotore e eventeve të ndryshme të zhvilluara nga fakulteti Ekonomisë. Panairi i Punës i Fakultetit të Ekonomisë, Universitetit të Tiranës, është një urë lidhëse për të gjithë ata që kërkojnë të ndërtojnë lidhje të reja, të zgjerojnë rrjetin e tyre profesional dhe të shfrytëzojnë mundësitë për të arritur sukses në karrierë. Kjo traditë vazhdon të jetë një shembull i bashkëpunimit dhe inovacionit në rrugën drejt një të ardhmeje më të ndritshme ekonomike dhe

profesionale, si për studentët ashtu edhe për kompanitë pjesëmarrëse dhe dhanë një mesazh shumë të rëndësishëm mbi menaxhimin e parave në familje dhe rëndësinë e tyre. Por eventi u përmbyll dhe me surpriza për fëmijët.

3.6. Albsig, pjesë e panairit të organizuar nga Western Balkans University

Western Balkans University, në bashkëpunim me Dhomën Britanike të Tregtisë në Shqipëri, organizoi Panairin e Karrierës, që solli së bashku mbi 60 biznese dhe institucione për t'u ofruar studentëve një pasqyrë reale të botës së punës. Albsig, pjesë e Kastrati Group, ishte krenare të ishte pjesë e këtij aktiviteti, duke sjellë në stendën e saj eksperiencën dhe energjinë e një ekipi të përkushtuar.



Studentët e WBU u treguan mjaft të interesuar për mundësitë e internshipeve dhe bashkëbiseduan me ekspertët tanë për të kuptuar më mirë si mund të integrohen në tregun e punës. Për shumë prej tyre, ky panair ishte një hap i parë i rëndësishëm drejt një karriere të suksesshme. Albsig, si gjithmonë, mbështet iniciativat që nxisin zhvillimin profesional të të rinjve dhe i orienton ata drejt mundësive konkrete për praktikë dhe punësim.

3.7. Albsig – një dritare mundësish për të rinjtë në Panairin e Punës dhe Karrierës 2024, realizuar nga Fakulteti i Biznesit, UAMD

"Panairi i Punës dhe Karrierës 2024" në Fakultetin e Biznesit pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu" erdhi edhe këtë vit si mundësi e shkëlqyer e studentëve të këtij institucioni arsimor. Shoqëria e Sigurimeve Albsig pjesë e Kastrati group, në një stendë moderne, e cila ishte ideuar dhe dizajnuar me frymën moderne të komunikimit vizual, mirëpriti të gjithë studentët e interesuar të bëhen pjesë e Albsig. Albsig ka qenë dhe do të mbetet promotore e brezave të rinj përfshirë studentët e të rinjë që morën pjesë në panair. Stenda e Albsig mirëpriti një numër të konsiderueshëm studentësh, e të rinjsh të cilët, shprehën dëshirën të bëhen





pjesë e stafit të Albsig. Por kishte dhe nga ata studentë që dakortësuan që të zhvillojnë dhe internshpet e kërkuara nga kurrikulat shkollore. Albsig numëron një listë të konsiderueshëm të studentëve që nëpërmjet panairove dhe work-shopeve janë bërë pjesë e stafit të kompanisë.

Panairi i Punës dhe Karrierës 2024, ky aktivitet vjetor, i cili mbajti edicionin e tij të katërt, synoi të ndërtojë ura lidhëse mes studentëve dhe tregut të punës, duke sjellë së bashku institucionet shtetërore, sipërmarrjen private dhe talentet e reja. Dekani i Fakultetit të Biznesit në fjalën e tij përshëndetëse, theksoi rëndësinë e përshtatjes së kurrikulave akademike

me nevojat e vazhdueshme të tregut të punës dhe vlerësoi rolin e panairit në ofrimin e mundësive të praktikave profesionale dhe punësimit për të rinjtë.

Panairi ofroi mundësi të shumta për studentët përmes 160 bizneseve të pranishme përfshirë dhe Albsig të cilët hapën dyert për trajnime, praktika dhe mundësi punësimi. Ky panair tashmë është bërë një traditë që premtan të rrisë ndikimin dhe të ndërtojë më shumë ura midis akademisë dhe tregut të punës, duke siguruar që studentët të jenë gati për sfidat e ardhshme profesionale.

3.8. "Albsig Fan Zone", hapësirë dedikuar komunitetit në mbështetje të Kombëtares Shqiptare

"Albsig Fan Zone", është risia që ka shtuar së fundmi kompania e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati group, në mbështetje të Kombëtares Shqiptare në European. "Kuç e zi, me Albsig me vete për shpresën e fitores", janë këto mesazhe të rëndësishme që Albsig udhëzon sportdashësit që të pajisen me sigurimin e shëndetit në udhëtim në çdo moment. Albsig ka krijuar hapësirë të dedikuar në mbështetje të Kombëtares Shqiptare të Futbollit. "Albsig Fan Zone", është hapësira e krijuar për sportdashësit, e cila ndodhet në ambientet e jashtme të Mak Albania Hotel. Ambienti është i pajisur me ekran të madh gjigand për transmetimin e drejtpërdrejtë të ndeshjeve si dhe ambiente rekreative dhe aktivitete të ndryshme për tifozët e të gjitha moshave. Ky aktivitet do të përfshijë lojëra të ndryshme, zona të dedikuara për fëmijë dhe stenda pijesh e ushqimesh.

"Ne jemi të lumtur që kontribuojmë në krijimin e ambienteve festive në mbështetje të Kombëtares Shqiptare. Besojmë se kjo Fan Zone do të ndihmojë tifozët të ndihen më afër njeri-tjetrit dhe skuadrës gjatë ndeshjeve", tha njëri nga menaxherët e Albsig.



Realizimi i "Albsig Fan Zone" pritet që të tërheqë mijëra tifozë dhe të krijojë atmosferë të paharrueshme për kampionatin, duke demonstruar njëkohësisht përkushtimin e Albsig për të qenë një pjesë aktive e komunitetit dhe në mbështetje të sportit shqiptar.

Këtë vit, teksa Kampionati European po afron, interesi është shumë më i lartë edhe për një arsye tjetër. Për herë të dytë në histori, Shqipëria ka arritur që të kualifikohet në "Euro 2024". Një skuadër me lojtarë të fortë, me ndeshje cilësore e fitore të pastra, që arriti të kualifikohet me meritë që një ndeshje para se të përfundonin eliminatorët, i ka emocionuar të gjithë. Këto emocione pritet të kulmojnë me fillimin e Europianit që do të zhvillohet në Gjermani, nga data 14 qershor deri më 14 korrik 2024.



Nëse ka një ngjarje që rrit krenarinë kombëtare të shqiptarëve dhe u jep atyre shumë emocione është pikërisht futbolli. Teksa shpresat për kualifikim shtoheshin ndeshje pas ndeshjeje gjatë fazës së Eliminatorëve, interesi për të ndjekur lojën e skuadrës kuqezi vetëm rritej dhe për këtë Albsig ka krijuar kushtet e përshtatshme për tifozët e të gjitha moshave që të shikojnë ndeshjet në ambijente komode e rekreative.

3.9. Analiza 7-mujore e punës në Albsig: Performanca e suksesshme finaciare, reduktim i kostove dhe zgjidhja e shpejtë e kërkesave të klientëve. Albsig shpërblen punonjësit

Pas një analize të detajuar të punës për shtatëmuajorin e parë të këtij viti, rezultatet janë tejet pozitive dhe shumë të suksesshme në të gjitha aspektet kyçe të shoqërisë. Në një raport të përmbledhur të analizave të detajuara të performancave mujore, iu ofrua stafit një vështrim i detajuar mbi arritjet e çdo muaji përmbledhur dhe në 7-mujorin e parë të këtij viti si dhe sfidat e kapërcyera dhe strategjitë që do të vazhdojnë të çojnë përpara Albsig-un. Jo vetëm kaq, por performanca operationale gjithashtu thuhet se ka qenë e shkëlqyer, me një përmirësim të ndjeshëm në shërbimet ndaj klientit dhe një ulje të ndjeshme të kohës së përgjigjeve për kërkesat e klientëve. Këto përmirësime duket se kanë reflektuar në angazhimet e Albsig për të siguruar një përvojë të jashtëzakonshme me çdo klient. Duket se të gjitha bilancet mujore të përmbledhura nën shifrën e përgjithshme të punës së shtatëmuajorit të parë të këtij viti kanë ardhur në rritje për një numër të konsiderueshëm produktesh. Këto arritje duket se kanë ardhur falë një kombinimi të politikave të mira të marketingut, një shërbimi cilësorë ndaj klientit dhe zgjerimit të bazës së klientëve.

Rezultatet pozitive në shumë produkte e shërbime të Albsig duket se kanë arritur të reduktojnë edhe kostot operationale. Përmirësimet në proceset e brendshme dhe përdorimi me efikas i teknologjisë kanë kontribuar në këtë ulje të kostove duke e bërë operationin tonë më të qëndrueshëm financiarisht. Ndërsa analizojmë rezultatet pozitive të arritura deri tani, jemi të vetëdijëshëm se çdo sukses vjen me sfidat e tij. Albsig, gjatë kësaj periudhe është përballur me disa sfida të rëndësishme, të cilat e kanë ndihmuar të rritet dhe të përmirësohet në të gjitha proceset e saj. Duke bërë përpara, Albsig është përshtatur të vazhdojë këtë rrugë të rritjes dhe zhvillimit, duke përqendruar përpjekjet tona në përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve dhe produkteve të saj, si dhe në zgjerimin e pranisë së saj në treg. Analiza 7-mujore e punës në Albsig na ka dhënë një pasqyrë të qartë të progresit që kemi bërë dhe të mundësive që qëndrojnë përpara.

3.10. Albsig, trajnim të dedikuar për sigurimin e Paneleve Fotovoltaike

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve dhe përshtatjes me kërkesat e tregut, Albsig organizoi një trajnim të specializuar për stafin, në bashkëpunim me Aon Reinsurance

Solutions, një emër i njohur në zgjidhjet globale të risigurimit. Ky trajnim u përqendrua te siguri i paneleve fotovoltaike, një sektor me potencial të madh për zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë në Shqipëri. Ekspertët nga Aon ndanë njohuri të vlefshme dhe praktika më të mira ndërkombëtare për analizimin dhe menaxhimin e risqeve të lidhura me këtë teknologji.

Gjatë trajnimit, stafi i Albsig pati mundësinë të diskutojë mbi metodologji të reja për vlerësimin e rreziqeve dhe mbi procedurat për përmirësimin e procesit të sigurimit të këtyre produkteve të reja. Panelet fotovoltaike janë një hap i rëndësishëm drejt energjisë së rinovueshme në vendin tonë, dhe Albsig, duke synuar të jetë lider në sektorin e sigurimeve, ka vendosur të përfshihet aktivisht në këtë fushë të re. Trajnimi shërbeu si një platformë për të ndërtuar kapacitete të reja dhe për të përshtatur produktet e sigurimit me standardet dhe praktikatat më të avancuara në nivel global.



Përmes kësaj iniciative, Albsig dëshmon edhe një herë angazhimin e saj për zhvillimin profesional të stafit dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në promovimin e energjisë së gjelbër dhe të qëndrueshme në Shqipëri. Bashkë me partnerët ndërkombëtarë, Albsig vazhdon të jetë një hap përpara në ofrimin e zgjidhjeve inovative që i përgjigjen kërkesave në rritje të klientëve dhe tregut shqiptar.

3.11. Panairi “Karta e Studentit”: Një mundësi e re nga Albsig për studentët

Agjencia e Rinisë ka organizuar panairin “Karta e Studentit”, i cili u zhvillua në oborrin e Universitetit Politeknik të Tiranës, duke u shtrirë deri në Sheshin “Nënë Tereza” ku mori pjesë edhe Albsig, pjesë e Kastrati Group. Ky event është pjesë e një nisme më të gjerë për të mbështetur studentët dhe për të promovuar bizneset partnere që ofrojnë përfitime dhe zbritje për mbajtësit e Kartës së Studentit. Albsig ka qenë dhe do të mbetet kompania që mbështet gjithmonë brezat e rinj në rrugëtimin e tyre drejt profesionit. Sipas organizatorëve panairi synon të krijojë një platformë interaktive ku studentët mund të njihen me ofertat dhe shërbimet e ndryshme që ofrohen nga bizneset lokale.

Karta e Studentit, e njohur tashmë si një instrument i rëndësishëm mbështetës për rininë, siguron akses në shërbime dhe produkte me çmime të reduktuara, duke ndihmuar kështu studentët në përballimin e kostove të përditshme.


4.1. Hyrje

Përgjegjësia sociale është konsideruar një shtyllë thelbësore e filozofisë së Albsig, dhe është konkretizuar përmes një sërë nismash me impakt të drejtpërdrejtë në komunitet dhe mjedis. Albsig ka mbështetur institucionet arsimore në përmirësimin e kushteve të të nxëniet dhe edukimit, ka organizuar dhe mbështetur fushata të ndërgjegjësimit mjedisor me qëllim promovimin e sjelljeve të qëndrueshme, si dhe ka ofruar ndihmë të vazhdueshme për kategori të ndryshme të shoqërisë në nevojë, duke synuar fuqizimin social dhe mbrojtjen e dinjitetit njerëzor. Shoqëria ka qenë gjithashtu një mbështetëse aktive e aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive, si për të rinjtë ashtu edhe për të rriturit, duke kontribuar në promovimin e një jete komunitare të gjallë dhe gjithëpërfshirëse. Përmes këtij angazhimi të shumëanshëm, Albsig ka afirmuar vizionin e saj për të qenë më shumë se një kompani sigurimesh, një faktor i rëndësishëm në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë, më të shëndetshme dhe më të qëndrueshme.

4.2. Një ditë në Albsig, Iden pjesë e projektit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania

Në mbështetje të programit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania, ishte me ne sot në Albsig, Iden. Gjimnazistja nga Tirana, e cila sot ka qenë pjesë dhe ka drejtuar kompaninë për një ditë. E reja është njohur me të gjithë drejtuesit e kompanisë dhe njëkohësisht ka parë më nga afër të gjithë punën e departamenteve të shoqërisë.

Iden Nano, 18 vjeçarja ka qëndruar përgjatë një dite në Departamentin e Marketingut dhe ka parë më nga afër punën e këtij departamenti. “E shikoj më afër marketingut veten time në të ardhmen”, theksoi Iden në një bashkëbisedim me ekspertin e mediave në Albsig. Ajo shtoi se e shikon veten në një të ardhme të afërt si financiere ose marketiere të zonjën. Shumë të lumtur të jemi pjesë e projektit “Drejtues për një ditë” nga Junior Achievement of Albania. Një ndër pikat ku të gjithë mund të pajtohemi është domosdoshmëria e edukimit joformal, punës praktike dhe vullnetarizmit. Mungesa e këtyre të trijave dhe përditshmëria e sistemit të edukimit shumë lehtë mbyt ambiciet në pothuajse çdo individ. Në një treg si ky i Shqipërisë ku mundësitë e zhvillimit nuk vijnë vetë, një i ri duhet të hapë rrugën dhe t’i gjejë vetë mundësitë, shpeshherë të fshehura. Dhe për të lehtësuar sadopak këtë rrugë Albsig synon krijimin e mundësive të reja për punësim dhe vetëpunësim të të rinjve të talentuar, nëpërmjet ndërthurjes së teknikave të hershme me elementë të rinj artistikë.





4.3. Albsig: Festa e 1 Qershorit me fëmijët e stafit në bregdetin e Durrësit.

Shoqëria e Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, organizoi një festë të veçantë për 1-Qershorin në bregdetin e Durrësit, duke mbledhur së bashku fëmijët e stafit të saj për një ditë plot argëtim dhe aktivitete kreative e lojërash të ndryshme për të vegjëlit. Eventu filloi me një ceremoni mirëseardhjeje ku organizatorët e eventit përshëndetën prindërit të pranishëm dhe uruan fëmijët me rastin e festës së 1-Qershorit.

Aktivitetet e ditës përfshinë lojëra të ndryshme në rërë, piktura, gara sportive e lojra argëtuese. Gjithashtu, u organizua një konkurs për ndërtimin e kështjellave prej rëre, ku fëmijët mund të shfaqnin kreativitetin e tyre, në të cilën shfaqën dhe aftësitë e tyre në skulptura dhe piktura. Përveç lojërave dhe aktiviteteve argëtuese u siguroi dhe një zonë e veçantë për ushqim dhe pije për të vegjëlit, ku fëmijët dhe prindërit mundën të shijonin një drekë të shijshme buzë detit. Një ndër momentet kulminante të festës ishte vizita e animatorëve që përformuan numrat e tyre të ideuar pikërisht për atë ditë. Por atmosfera festive kulmoi dhe u plotësua me muzikë dhe kërcime edhe nga prindërit e të vegjëlve.

Festa e 1 Qershorit organizuar nga Albsig u vlerësua shumë pozitivisht nga të pranishmit dhe u konsiderua si një ndër eventet më të bukura nga të pranishmit duke sjellë gëzim dhe buzëqeshje fëmijëve dhe prindërve shoqëruar. 1 qershori këtë vit në Albsig erdhi me shumë ngjyra, muzikë e argëtim, pikërisht për shkak se Dita e Fëmijëve iu kushtua krejtësisht më të dashurve tanë, edhe në ambientet me të dashur për ta siç ishte bregdeti i Durrësit. Stafi i ALBSig bashkë me fëmijët e tyre morën pjesë në festën e organizuar për këtë ditë derisa mesazhi kryesor i prindërve ishte ai për zhvillimin e mëtejshëm të kulturës mbi sigurimet.





4.4. Albsig mbështet trupën e Portokallisë në Serialin e Verës, "Verë dhe Portokalle".

Kompania e Sigurimeve Albsig ka mbështetur trupën e njohur të humorit "Portokalli" në kuadër të serialit të tyre të verës, "Verë dhe Portokalle". Ky bashkëpunim

vjen si përpjekje për të promovuar artin dhe kulturën shqiptare duke sjellë humor dhe argëtim në qytete të ndryshme të Shqipërisë. Spektakli "Verë dhe Portokalle" është një iniciativë e njohur e spektaklit "Portokalli", që përfshin performanca humoristike dhe artistike në sheshet e qyteteve të ndryshme.

Këtë vit ndalesa e trupës së portokallisë ka përfshirë dhe Hamallajn, ku publiku i gjithë rrethina të qytetit të Durrësit ka ndjekur nga afër artistët e tyre të preferuar. Aktorët e humorit duket se nuk kanë bërë asnjë ditë pushim këtë verë por i janë përkushtuar spektatorit duke u falur artdashësve të humorit një spektakël të veçantë. "Verë dhe Portokalle" u ndal edhe në Hamallaj për t'i falur humorin dhe një natë plot emocione publikut që e priti me duartrokitje spektaklin. Ndryshe nga herët e tjera, kjo puntatë spektakli ndër më të kërkuarit dhe më të shikuarit i humorit shqiptar, u mbështet nga Albsig, pjesë e Kastrati group.

Albsig, një ndër kompanitë më të suksesshme të sigurimeve në Shqipëri, ka mbështetur me sponsorizim puntatën e radhës së spektaklit të humorit "Portokalli" në kuadër të serialit të verës "Verë dhe Portokalle". Këto seriale janë zhvilluar tashmë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, si Korca Policani, Gramshi, Kamza, Hamallaj e shumë qytete të tjera. Në sheshet kryesore spektakli i humorit mbledhi publikun vendas për të shijuar humorin dhe performancat e aktorëve të tyre të preferuar. Si çdo vit, turi i "Verë dhe Portokalle" mbledhi në sheshe qytetarë të shumtë që prisnin me padurim të shijonin nga afër humorin, performancat e artistëve dhe gjithçka ky spektakël dhuroi. Në këtë takim të artistëve me publikun Hamallaj që ndryshe nga çdo fundjavë e vitit, nuk zhvillohej përmes ekranit por në një skenë të vendosur në qendër të qytetezës e ku sytë e publikut ndoqën me kërkshëri çdo moment, emocionet e artistëve janë të shumëfishta. Pas Hamallaj, spektakli Verë dhe Portokalle që shënon një prej eventeve më të bukura verore, do të ndalej në Kukës. Albsig mbështeti këtë nismë duke synuar të promovojë jo vetëm markën e saj, por edhe të kontribuojë në zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe artistike në Shqipëri. Ky bashkëpunim reflektoi në angazhimin e kompanisë për të mbështetur eventet që bashkojnë komunitetin dhe nxisin atmosferë pozitive dhe të gjallë në vend.

Shfaqja e humorit Verë e Portokalle, mbështetur nga Albsig, udhëtoi dhe në qytetin e Kukësit. Në sheshin qendror në qytetin e Kukësit është zhvilluar dhe portokallia e radhës. Të gjithë artëdashësit janë shpërngulur në sheshin e qytetit për të parë më nga afër artistët e tyre të preferuar të humorit dhe jo vetëm. Ky lloj aktiviteti është pjesë e një turneu shfaqjesh, ku ajo prezantohet në qytetet e ndryshme të shqipërisë, duke sjellë argëtim për të gjithë komunitetin e zonës. Aktorët që çdo të dielë mbajnë para ekranit publikun shqiptar, tashmë po i takojnë ata nga afër qytet pas qyteti. Pjesëmarrja masive ka qenë e dukshme, me të qeshura dhe emocione dhe humorin e papërsëritshëm të "Portokalli". Çdo numër është përgatitur nga fillimi për t'ju përshtatur motos "Verë dhe Portokalle". Turneu do të vijojë deri më 15 gusht. Mbështetja financiare e Portokallisë nga Albsig shpreh gjithmonë gatishmërinë dhe përhapjen e këtyre ngjarjeve kulturore në zonat më të skajshme të vendit.

4.5. Shkolla "Santa Marcellina" në Sarandë, 12 vite përkushtim për Sigurimin e Nxënësve në Albsig.

Prej 12 vitesh shkolla "Santa Marcellina" në Sarandë ka qenë një shembull i shkëlqyer për kujdesin dhe sigurinë që ofron për nxënësit e shkollës së saj. Jo vetëm kaq, por drejtuesit e këtij institucioni arsimor kanë bërë të mundur edukimin e prindërve për rëndësinë e sigurimit të nxënësve. Si një institucion që i jep përparësi shëndetit dhe mirëqenies së çdo nxënësi, "Santa Marcellina" ka zgjedhur të sigurojë të gjithë nxënësit e saj me një nga kompanitë më të besueshme të sigurimeve në vend siç është Albsig, pjesë e Kastrati Group. Numëron plot 12 vite që bën të mundur sigurimin e nxënësve nga aksidentet. Jo vetëm kaq por vetëm kësaj përvoje dhe përkushtimi kanë qenë vetë prindërit e kësaj shkolle që vitet e fundit janë interesuar edhe ata vetë për sigurimin e fëmijëve.

Qysh prej fillimit të bashkëpunimit me Albsig shkolla "Santa Marcellina" ka siguruar që çdo nxënës të jetë i mbrojtur nga rreziqet e ndryshme që mund të ndodhin gjatë procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtëshkollore. Ky përkushtim për sigurinë e fëmijëve është një tregues i rëndësishëm që shkolla i jep rëndësi mjedisit të sigurtë dhe të shëndetshëm për zhvillimin e nxënësve. "Santa Marcellina" është një institucion arsimor që e ka vlerësuar gjithmonë sigurinë dhe mbrojtjen e komunitetit saj. Në këtë kuadër, zgjedhja e një kompanie të besueshme për sigurimin e nxënësve ka qenë gjithmonë një ndër përparësitë kryesore. Për këtë arsye po shkon për më shumë se dy dekada që shkolla ka zgjedhur Albsig, një ndër kompanitë lider në tregun e sigurimeve në vend për sigurimin e fëmijëve.

Albsig ka qenë zgjedhja e parë për shkollën "Santa Marcellina", për shkak të reputacionit të saj si një ndër kompanitë e sigurimeve më të besuarat në tregun e sigurimeve sot në Shqipëri dhe një ndër kompanitë që dëmshpërblen në kohë rekord çdo dëm kundrejt çdo procedure të kërkuar. Jo vetëm kaq, por Albsig është e njohur për ofrimin e shërbimeve të personalizuar që përmbushin nevojat specifike të klientëve të vegjël. Shkolla "Santa Marcellina" ka përfituar nga ky focus në kujdesin ndaj klientit, duke marrë një paketë sigurimi që është krijuar posaçërisht për të mbuluar çdo rrezik të mundshëm që mund të prekë nxënësin, stafin pedagogjik gjatë dhe pas mësimin. Përkushtimi i Albsig për të ofruar shërbime të shkëlqyera ka krijuar një marrëdhënie besimi dhe sigurime që ka vazhduar dhe do të vazhdojë për dekada me radhë.

Albsig ka një histori të gjatë në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të sigurimit me një ekip të përzgjedhur dhe me përvojë shumëvjeçare në këtë fushë. Kjo përvojë ka qenë një faktor kyç në suksesin e bashkëpunimit të tyre me shkollën. Përvoja dhe ekspertiza e Albsig-ut kanë garantuar që çdo incident ose problem të zgjidhet shpejt dhe me efikasitet duke minimizuar ndikimin në funksionimin e përditshëm të shkollës.

4.6. Albsig dhe Qendra për Edukim Kulinar: Një Ditë Gatimi Plot Dashuri për Fëmijët në Nevojë.

Albsig organizoi një aktivitet të veçantë bamirësie në bashkëpunim me Qendrën për Edukim Kulinar (QEK), me qëllim mbështetjen e fëmijëve në nevojë përmes gatimit të ushqimeve të shëndetshme dhe të shijshme për të gjitha moshat. Ky aktivitet u mirëprit nga stafi i Albsig, ku morën pjesë 11 punonjës të cilët jo vetëm kontribuan me kohën dhe energjinë e tyre pozitive, por edhe krijuan një atmosferë të ngrohtë dhe të gëzueshme në ambientet e kuzhinës.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte ofrimi i vakteve të shëndetshme për fëmijët që ndodhen në situata të vështira ekonomike dhe sociale. Gatimi i përbashkët u kthye në një eksperiencë bashkëpunimi dhe kreativiteti, ku punonjësit e Albsig jo vetëm treguan aftësitë e tyre në kuzhinë, por u angazhuan për të ofruar ushqime të shijshme dhe të servitura me përkujdesje. Një nga aspektet më të bukura të këtij aktiviteti ishte ndërveprimi i stafit të Albsig me profesionistët e kulinarisë, duke mësuar teknika të reja gatimi dhe duke përfituar nga përvoja edukative që ofron kjo qendër. Ky event ishte një mundësi për të kombinuar përgjegjësinë sociale të Albsig me ndihmën direkte për komunitetin, duke rritur frymën e bashkëpunimit brenda ekipit.

Për Albsig, përgjegjësia sociale nuk është thjesht një detyrim korporativ, por një mision i rrënjësor thellë në vlerat e kompanisë. Aktiviteti i fundit, organizuar në bashkëpunim me QEK, ishte një iniciativë për të



ofruar vakte të ngrohta për fëmijët në nevojë dhe për të krijuar një ndjenjë të veçantë kënaqësie për punonjësit që morën pjesë. Ky aktivitet është pjesë e strategjisë së përgjegjësisë sociale që Albsig ka ndërmarrë për të bërë ndryshime pozitive në shoqëri. Përmes partneriteteve dhe nismave të ndryshme që mbështesin grupet më të ndjeshme, Albsig tregon se mbështetja e komunitetit është një prioritet i rëndësishëm. Duke vendosur një standard të lartë për Përgjegjësinë Sociale në sektorin e sigurimeve, Albsig synon të vazhdojë me organizime të tjera bamirësie dhe sociale, për të ndihmuar jo vetëm fëmijët, por edhe komunitetet e prekura nga varfëria apo sfida të tjera sociale. Me përkushtim dhe angazhim, Albsig vazhdon të kontribuojë në përmirësimin e jetës së njerëzve në nevojë.



4.7. Albsig dhe Kastrati Construction ofrojnë vizita falas për gratë dhe vajzat e stafit në kuadër të Tetorit Rozë në Turkish Hospital.

Tetori në Albsig hap siparin rozë me simbolikat e këtij muaji. Që në hyrje të zyrave qendrore të shoqërisë së Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, të pret një baner dhe një glob qelqi i mbushur me fjongot rozë, simbolika e këtij muaji. Dhe jo vetëm kaq, por çdo punonjës dhe çdo klient këtë muaj në Albsig respekton simbolikën që fjongoja rozë mbart. Në kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit për luftën kundër kancerit të gjirit, Albsig dhe Kastrati Construction kanë marrë përsipër një nismë të rëndësishme për të mbështetur vajzat dhe gratë, duke organizuar vizita mjekësore falas për të gjitha koleget femra përfshirë dhe ato të kompanive të tjera të Kastrati Group.

Ndryshe nga vitet e tjera, këtë tetor në këtë iniciativë kaq të rëndësishme dhe domethënëse, nismës së përvitshme të Albsig i është bashkuar dhe Kastrati Construction me të gjithë stafin përkatës. Për dy kompanitë e Kastrati Group, duket se ky bashkëpunim është bërë dhe do të bëhet thuajse në çdo vit në kuadër të mirëqenies së punonjësve, i cili është realizuar në partneritet me Turkish Hospital, një nga spitalet më të njohura dhe më të avancuara në vend. Shëndeti i stafit është një përparësi për Albsig, dhe kjo iniciativë përforcon përkushtimin e kompanisë për të ofruar jo vetëm siguri financiare përmes produkteve të sigurimeve, por edhe mbështetje reale për mirëqenien fizike dhe mendore të punonjësve. Kujdesi për shëndetin e grave është një investim i rëndësishëm për mirëqenien afatgjatë të stafit dhe i jep një mesazh të qartë komunitetit të biznesit: mirëqenia e stafit është baza për suksesin e çdo kompanie.

Punonjëset e Albsig dhe partnerët e saj janë inkurajuar të përfitojnë nga kjo mundësi e rëndësishme. Kontrollat falas në Turkish Hospital përfaqësojnë jo vetëm një shërbim me vlerë financiare, por edhe një siguri dhe qetësi mendore për të gjitha gratë që kujdesi për shëndetin e tyre është një prioritet. Vizitat do të realizohen gjatë muajit tetor, duke i mundësuar secilës punonjëse të gjejë kohën e përshtatshme për t'u kontrolluar. Ky është një shembull i fuqishëm i përgjegjësisë sociale që ndërmarrjet si Albsig dhe Kastrati Construction tregojnë ndaj stafit të tyre. Iniciativa e Tetorit Rozë mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien e stafit të Albsig dhe Kastrati Construction, duke zgjeruar ndjeshëm ndërgjegjësimin për shëndetin dhe kujdesin personal në mjedisin e punës.

Në përputhje me misionin e saj për të qenë gjithmonë pranë punonjësve dhe për të promovuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre, Albsig përmes bashkëpunimit me Turkish Hospital kanë sjellë një mundësi të vyer për stafin e kompanisë. Me nisma të tilla, siguria dhe kujdesi për jetën bëhen realitet, duke përforcuar përkushtimin për të bërë ndryshim pozitiv për punonjësit dhe komunitetin.



4.8. Albsig merr pjesë në "Ping Pong Business Tournament" dhe promovon rëndësinë e sportit në komunitetin e biznesit.

Më 8 dhjetor 2024, Albsig, si pjesë e Kastrati Energy Trade, ishte pjesëmarrëse në edicionin e radhës të "Ping Pong Business Tournament," një ngjarje e veçantë që u zhvillua në Pallatin e Rinisë. Ky aktivitet sportiv shënoi jo vetëm një platformë për kompeticion, por edhe një hapësirë për të forcuar marrëdhëniet mes kompanive dhe për të promovuar vlerat e shëndetit dhe mirëqenies përmes sportit. Pjesëmarrja e Albsig në këtë turne merr një rëndësi të veçantë, veçanërisht këtë vit kur kompania feston 20-vjetorin e saj. Kjo ngjarje është një mundësi për të theksuar angazhimin e Albsig në përkrahjen e iniciativave që ndërthurin aktivitetet sportive dhe komunitare, duke theksuar rolin e rëndësishëm të sportit si një faktor kyç për shëndetin fizik dhe mendor, si për individët, ashtu edhe për kolektivat e kompanive.



Sportet si ping-pongu, përveçse ndihmojnë në ndërtimin e një stili të shëndetshëm jetese, ofrojnë një mënyrë të shkëlqyer për të forcuar ekipet brenda organizatave dhe për të nxitur bashkëpunimin mes kompanive në një ambient të qetë dhe argëtues. Për Albsig, përfshirja në aktivitete të tilla reflekton vizionin e saj për të mbështetur jo vetëm klientët, por edhe punonjësit dhe komunitetin më të gjerë, duke promovuar vlera pozitive dhe një qasje holistike ndaj biznesit dhe shoqërisë. Turneu u organizua nga 11 Points dhe Priping, dhe pritet të mirëpresë pjesëmarrës nga kompani të ndryshme që ndajnë të njëjtën frymë sportiviteti dhe miqësie. Me sloganin e saj të përkushtimit dhe suksesit ndër vite, Albsig do të jetë një ndër shembujt kryesorë të harmonizimit të biznesit me përgjegjësinë sociale.



4.9. Albsig Investon në veshje për fëmijët me aftësi ndryshe në qendrën "Zëra Jete" në Elbasan!

Auditimi i brendshëm ka realizuar kënaqshëm aktivitetet e planifikuara në planin e auditimit të Një akt domethënës solidariteti dhe përkujdesjeje, Albsig ka ndërmarrë një iniciativë mbresëlënëse për të mbështetur fëmijët me aftësi ndryshe që frekuentojnë qendrën "Zëra Jete" në Elbasan. Ky investim i kompanisë nuk është vetëm një ndihmë praktike, por një mesazh i qartë për një shoqëri që duhet të jetë më përfshirëse dhe më e drejtë për të gjithë. Fëmijët me aftësi ndryshe shpesh përballen me sfida të shumta në përditshmërinë e tyre, duke përfshirë vështirësitë ekonomike dhe sociale.

Përmes këtij gjesti human, Albsig ka sjellë një frymë të re solidariteti në jetën e tyre. Investimi në veshje cilësore jo vetëm që i ndihmon ata të përballen me nevojat e përditshme, por gjithashtu i fuqizon duke rritur vetëbesimin dhe ndjenjën e përkatësisë. Për fëmijët në “Zëra Jete”, veshjet e reja përfaqësojnë më shumë se thjesht një dhuratë materiale. Ato janë një simbol i mbështetjes, dashurisë dhe pranimit nga një kompani që sheh përtej detyrimeve të saj komerciale dhe kontribuon në mirëqenien e komunitetit.

Në qendrën “Zëra Jete” u zhvillua një aktivitet i veçantë, ku përfaqësues të Albsig shpërndanë veshje për fëmijët, duke e kthyer këtë ditë në një moment të paharrueshëm për ta. Atmosfera ishte e mbushur me buzëqeshje, përqafime dhe ndjenja mirënjohjeje, duke treguar ndikimin e madh që një akt i tillë ka në jetën e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre. “Ne besojmë se kujdesi për fëmijët është investimi më i vlefshëm që mund të bëjmë si kompani dhe si shoqëri. Fëmijët me aftësi ndryshe meritojnë dashurinë dhe mbështetjen tonë për të ndërtuar një të ardhme ku ata ndihen të barabartë dhe të vlerësuar.” u shpreh një nga përfaqësuesit e marketingut të Albsig.

Kjo nismë nuk është një rastësi, por pjesë e vizionit afatgjatë të Albsig për të kontribuar në një shoqëri më të barabartë. Kompania ka qenë gjithmonë e angazhuar përtej sigurimeve, duke investuar në kauza që mbështesin komunitetet në nevojë dhe që promovojnë solidaritetin dhe përfshirjen sociale. Përmes këtij projekti, Albsig shpalos një shembull të fuqishëm se si bizneset mund të luajnë një rol kyç në përmirësimin e jetës së njerëzve, duke ndihmuar ata që kanë më shumë nevojë dhe duke ndërtuar ura komunikimi dhe mirëkuptimi në shoqëri.



Iniciativa e Albsig është një ftesë për të gjithë aktorët e tjerë të shoqërisë — bizneset, organizatat dhe individët — që të bashkohen në përpjekjet për të krijuar një botë më të mirë për fëmijët me aftësi ndryshe. Kujdesi dhe mbështetja për këta fëmijë janë jo vetëm një detyrë morale, por edhe një mundësi për të ndërtuar një të ardhme ku diversiteti vlerësohet dhe fuqizohet.

Përmes këtij akti domethënës, Albsig ka treguar se ndryshimi fillon nga gjestet e vogla, por me ndikim të madh. Mbështetja e ofruar për fëmijët e qendrës “Zëra Jete” nuk është thjesht një dhuratë, por një investim në dinjitetin, lumturinë dhe të ardhmen e tyre.

“Një shoqëri e fortë ndërtohet duke kujdesur për ata që kanë më shumë nevojë. Albsig, gjithmonë pranë komunitetit!”

5.1 Objektivi dhe qëllimi i Auditimit të Brendshëm

Ky raport synon të informojë Bordin Mbikëqyrës, Administratorët dhe palët e interesuara mbi funksionimin, efektivitetin dhe vlerën e shtuar që ofron Njësia e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë "Albsig" sh.a. Auditimi i Brendshëm ka për objektiv kryesor sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së shoqërisë me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, përfshirë ligjet, aktet nënligjore si dhe rregulloret e brendshme. Gjithashtu, Njësia funksionon si një mekanizëm i rëndësishëm kontrolli dhe konsulence për strukturat drejtuese të shoqërisë, duke ndihmuar në:

- Forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Sigurimin e integritetit dhe besueshmërisë së informacionit financiar e operacional;
- Përdorimin efikas të burimeve të disponueshme;
- Identifikimin e risqeve dhe përmirësimin e proceseve të menaxhimit të tyre.

Në përmbushje të rolit të saj, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka ushtruar aktivitetin në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm, si dhe me Kod Etike të Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm (IIA). Për periudhën e raportuar, kuadri rregullativ i brendshëm mbi të cilin bazohet funksioni i auditimit nuk ka pasur nevojë për rishikim, duke reflektuar një stabilitet të qëndrueshëm në praktikën e kontrollit të brendshëm.

5.2 Metodologjia dhe parimet e Auditimit të Brendshëm

Auditimi i Brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me Kartën e Auditimit të Brendshëm, e cila përcakton misionin, qëllimin, objektivat dhe përgjegjësitë e këtij funksioni brenda strukturës organizative të Shoqërisë. Gjithashtu, njësia ka respektuar kërkesat e Rregullores "Për veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në Shoqërinë e Sigurimit", miratuar me vendimin e Bordit nr. 153, datë 23.12.2014, si dhe ka ndjekur praktikën më të mira ndërkombëtare të rekomanduara nga Instituti Ndërkombëtar i Audituesve të Brendshëm (IIA).

Hartimi i Planit Vjetor të Auditimit është mbështetur në një analizë të detajuar të riskut, duke identifikuar proceset më të rëndësishme të aktivitetit të Shoqërisë dhe duke përcaktuar prioritetet sipas nivelit të riskut dhe impaktit të mundshëm. Kjo qasje metodologjike synon maksimizimin e vlerës së shtuar dhe sigurimin e një mbulimi të efektshëm të fushave kritike të veprimtarisë. Gjatë periudhës së raportimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar të gjitha angazhimet e planifikuara në përputhje me Planin Vjetor të miratuar. Gjetjet, rekomandimet dhe përmirësimet e identifikuar janë adresuar në raporte të veçanta auditimi, të cilat i janë komunikuar menaxhimit të Shoqërisë për veprime të mëtejshme.

5.3 Pohimi për pavarësinë

Gjatë gjithë periudhës së raportimit, aktiviteti i Auditimit të Brendshëm në shoqërinë "Albsig" sh.a. është ushtruar në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrje të jashtme në organizimin, përcaktimin e objektivave, metodologjisë, shpeshësisë së auditimeve apo përmbajtjes së raporteve përfundimtare.

Audituesi i Brendshëm nuk ka pasur përfshirje të drejtpërdrejtë në operacionet apo proceset që janë subjekt i auditimit, duke shmangur çdo konflikt interesi apo cenim të objektivitetit. Në këtë kuadër, nuk janë kryer veprime që mund të dëmtonin pavarësinë profesionale, siç janë: hartimi i procedurave operative, instalimi i sistemeve, përgatitja e të dhënave financiare apo ushtrimi i funksioneve menaxheriale.

Auditimi i Brendshëm konfirmon se gjatë vitit 2024 nuk është cënuar pavarësia institucionale apo profesionale e këtij funksioni. Punonjësit kanë vepruar në përputhje me standardet e integritetit, paanësisë dhe profesionalizmit, duke siguruar që informacioni i raportuar të jetë i saktë, i plotë dhe objektiv. Audituesi i Brendshëm ka demonstruar nivel të lartë gjykimi profesional në vlerësimin e proceseve të audituara, duke ruajtur balancën dhe duke mos u ndikuar nga interesa personale, familjare apo sociale.

5.4 Struktura organizative dhe raportimi

Funksioni i Auditimit të Brendshëm, në përputhje me organizimin e Shoqërisë, raporton në mënyrë të pavarur dhe të drejtpërdrejtë te:

- Komiteti i Auditimit;
- Këshilli Mbikëqyrës;
- Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë.

Për të ruajtur standardet profesionale dhe për të garantuar përditësimin e njohurive, personeli i Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka marrë pjesë në një sërë aktiviteteve trajnuese, programe certifikimi dhe zhvillimi profesional në fushën e auditimit dhe kontrollit të brendshëm.

5.5 Opinioni i Audituesit të Brendshëm

Gjatë vitit 2024, Auditimi i Brendshëm ka realizuar në mënyrë të suksesshme aktivitetet e planifikuara në kuadër të Planit Vjetor të Auditimit. Bazuar në raportet përfundimtare të auditimeve, sistemet e kontrollit të brendshëm janë vlerësuar me siguri të arsyeshme, ku shumica e proceseve janë klasifikuar si "Kënaqshëm" ose "Ka nevojë për përmirësim".

Nuk janë evidentuar gjetje kritike apo gabime materiale që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në funksionimin apo reputacionin e Shoqërisë.

Reziqet e identifikuar në auditime përfaqësojnë përgjithësisht risk të mbetur mesatar ose të ulët. Janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e procedurave operacionale, menaxhimin e informacionit, dokumentacionit dhe praktikave në fushat me ekspozim më të lartë ndaj riskut. Gjithashtu, është monitoruar vazhdimisht zbatimi i rekomandimeve për të siguruar ndikimin pozitiv dhe qëndrueshmërinë e përmirësimeve.

Bazuar në këto vlerësime, strukturat e kontrollit të brendshëm dhe korniza e qeverisjes në shoqërinë "Albsig" sh.a. konsiderohen të mirëstrukturuara dhe funksionale, duke mbështetur arritjen e objektivave strategjike të Shoqërisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar.

Auditimi i Brendshëm
Suela POPA

Menaxhimi i riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qënë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri- tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm. Standardi përcakton tiparet e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut në nivel të lartë. Kërkesat e mëtejshme dhe udhëzimet në lidhje me këto janë të mbuluara në seksione të tjera të standardeve dhe udhëzimeve të përcaktuara më poshtë:

Subjekti	Referenca në standarde/udhëzime
Strategjia e riskut	SR (Plani i Menaxhimit të Riskut)
Struktura qeverisëse e riskut	SQ (Departamenti i Riskut dhe IT)
Proceset e marrjes së vendimeve	PV
Vetëvlerësimi i identifikimit të riskut	VIR ORSA
Raportimi i riskut	RR
Plani i vijueshmërisë së veprimit	PVV

6.1. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Identifikimi i fushave të riskut, vlerësimi i riskut dhe më tej eliminimi, apo reduktimi i riskut në një nivel të pranueshëm duke kufizuar kostot financiare në minimumin e domosdoshëm. Menaxhimi i riskut lidhet me risqet dhe mundësitë që ndikojnë në krijimin e vlerave ose ruajtjen e vlerave të përcaktuar si më poshtë: Në Planin e menaxhimit të riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballlet shoqëria.

6.2 Vlerësimi i risqeve

Kjo fazë përfshin kuptueshmërinë e risqeve të identifikuara në fazën e mësipërme. Risqet e identifikuara do të vlerësohen në lidhje me:

- Mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të padëshiruar kur nuk ka aktivitete kontrolli ose kur ato janë të pamjaftueshme për të parandaluar apo ulur riskun;
- Pasojën që një ngjarje e padëshiruar do të kishte në shoqëri nëse do të ndodhte;
- Pasoja mund të jetë një lloj dëmi që shkaktohet ose mundësi që nuk shfrytëzohet (i cili mund të jetë sasior ose i përshkruar në terma specifik).

Vlerësimi i mësipërm do të marrë në konsideratë edhe kategorizimin sipas faktorëve të riskut. Bazuar në objektivat e vendosur, në fazën e parë, përdoren faktorët e riskut për të identifikuar më qartë ndikimin/peshën e ngjarjeve për secilin aspekt sipas rëndësisë. Ky proces zhvillohet në bashkëpunim me punonjësit përgjegjës të proceseve që janë vlerësuar gjithashtu. Për qëllime të kësaj metodologjie, peshash pecifike janë konsideruar si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Kategoritë/ faktorët e riskut	Pesha specifike për cdo factor
1	Reputacioni (R)	30%
2	Përputhshmëria (P)	30%
3	Operacionali (O)	20%
4	Financiar (F)	20%

Kjo analizë ndihmohet më së shumti nga fokus grupet për vlerësimin e riskut me punonjës të shoqërisë, sipas drejtorive ku punojnë. Mundësia e ndodhjes së riskut dhe ndikimi i tij, ndahet në tre kategori vlerësimi: i lartë/i moderuar/ i ulët.

Vlerësimi i riskut nënkupton renditjen e risqeve, duke filluar nga risqet më parësore që paraqesin impakt thelbësor në shoqëri dhe që mund të rrezikojnë efektshmërinë dhe reputacionin e tij, deri te risqet e ulëta të cilat nuk mund të kenë nevojë për masa, por mjafton të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme. Pas përcaktimit të mundësisë së ndodhjes së risqeve dhe pasojave të risqeve të ndodhura, vijohet me përcaktimin e nivelit të riskut për të gjitha risqet e identifikuar dhe të vlerësuara, sipas matricës së riskut. Mbështetur në vlerësimin e bërë për risqet, në këtë fazë vlerësohet rëndësia e risqeve për shoqërinë. Përkatësisht vendoset se cilat risqe do të pranohen dhe trajtohen sipas prioritetit të tyre. Renditja e risqeve bëhet sipas rëndësisë, dhe përfshin vlerësimin midis mundësisë së ndodhjes apo shfaqjes së një risku dhe impaktit/ndikimit të tij në shoqëri.

6.3 Kornizimi i riskut i shoqërisë Albsig Sh.a

Shoqëria Albsig sh.a. fokusohet te risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike. Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut. Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme. Shoqëria ka identifikuar si risqe kryesore ku dhe dhe ka orientuar skenarët e stresit si më poshtë: Risku i sigurimit, Risku i kreditit, Risku i tregut, Risku i likuiditetit, Risku operacional, Risku strategjik. Këto janë risqet kryesore që mund të kërcënojnë objektivat strategjike të shoqërisë, por ka dhe risqe të tjera si: Risku i këmbimit të monedhës së huaj, Risku reputacional, Risku i çmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik, në vecanti TPL. Risqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuar më poshtë:

✓ Risku i Kreditit

Risku i kreditit i referohet riskut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale të cilat rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kur pranohen primet fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj të siguruarve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut nga fondet e mbajtura, depozitat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme dhe bazuar dhe në kërkesa ligjore nga ku risiguruesit mund të kenë klasifikime BB ose norma më të larta dhe rreziku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar zbulimin ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave..

31 dhjetor 2024	A+	A	A-	AA	AA-	AA+	BB	Pa normë	Totali
në '000 Lekë									
Aktivët Financiare									
Investimet								2,144,028	2,144,028
Aktive të lidhura me risigurimin	8,213	13,335	556	-	31,888	-	436	-	54,428
Llogari të arkëtueshme								191,736	191,736
Aktive të tjera								71,781	71,781
Mjete monetare në arkë dhe bankë								105,866	105,866
31 dhjetor 2023	A+	A	A-	AA	AA-	AA+	BB	Pa normë	Totali
në '000 Lekë									
Aktivët Financiare									
Investimet	-	-	-	-	-	-	-	2,220,290	2,220,290
Aktive të lidhura me risigurimin	10,920	12,684	555	-	40,108	1,649	435	2,047	68,398
Llogari të arkëtueshme	-	-	-	-	-	-	-	127,974	127,974
Aktive të tjera	-	-	-	-	-	-	-	79,471	79,471
Mjete monetare në arkë dhe bankë	-	-	-	-	-	-	-	114,123	114,123

Informacione shpjeguese shtesë për primet e risigurimit të ceduara dhe aktivet e risigurimit sipas normës së kuotimit të risiguruesit janë si më poshtë:

	2024				2023			
	Primet e ceduara		Aktivete risigurimit		Primet e ceduara		Aktive të risigurimit	
	'000 Lek	% ndaj totalit	'000Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit	'000 Lek	% ndaj totalit
Norma								
AA	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%	-	0.0%
A+	31,142	14.6%	8,213	15.1%	29,801	13.3%	10,920	18.2%
A	41,846	19.7%	13,335	24.5%	41,667	18.6%	12,684	21.1%
A-	2,800	1.3%	556	1.0%	5,183	2.3%	555	0.9%
AA-	135,591	63.7%	31,888	58.6%	133,018	59.4%	31,808	52.9%
AA+	-	0.0%	-	0.0%	4,129	1.8%	1,649	2.7%
AAA	-	0.0%	-	0.0%	1,667	0.7%	-	0.0%
BBB	1,449	0.7%	436	0.8%	1,507	0.7%	435	0.7%
Pa norme	-	0.0%	-	0.0%	7,004	3.1%	2,046	3.4%
Totali	212,828	100%	54,428	100%	223,976	100.0%	60,097	100.0%

✓ Risku i Tregut

Vullnet në tregjet financiare, thelluar nga paqartësitë gjeopolitike dhe lëvizjet e interesave të ndryshueshme, paraqitën sfida për portofolion e investimeve. Shoqëritë e sigurimeve aplikuan strategjitë e diversifikimit të investimeve, protokollet e testimit të stresit dhe mekanizmat e mbrojtjes për tu mbrojtur ndaj lëvizjeve të tregut, duke ruajtur kthimin e investimeve dhe duke ruajtur raportet e likuiditetit brenda kufijve të rregullatorit. Risku i tregut për shoqërinë lidhet kryesisht me faktorë të tregut financiar, si normat e interesit dhe kurset e këmbimit, apo faktorë të jashtëm, si ecuria ekonomike, si dhe humbje nga portofoli i investimeve.

✓ Risku i sigurimit

Konkurrenca e rritur dhe dinamika e ndryshuar e tregut detyroi një rishikim të strategjive të nënshkrimit. Siguruesit zbatuan analizat e avancuara të të dhënave dhe algoritmet e mësimi automatik ML për të përmirësuar saktësinë e vlerësimit të riskut, për të lehtësuar zgjedhjen e riskut të dëmshëm dhe për të optimizuar modelet e çmimeve, duke siguruar një rentabilitet të qëndrueshëm të nënshkrimit ndër vite ndaj modeleve të lëvizjeve të pasurive. Shoqëria menaxhon riskun e saj nëpërmjet strategjisë së nënshkrimeve dhe risigurimeve me një strukturë domethënëse të menaxhimit të riskut. Çmimi bazohet në supozimet të cilat kanë parasysh tendencat dhe eksperiencën e mëparshme. Shoqëria shkruan fillimisht risqet e sigurimit të pasurisë, sigurimit financiar dhe sigurimit të automjeteve me një maturitet deri në 12 muaj. Risqet kryesore vijnë si rezultat i fatkeqësive natyrore, ndryshimet klimaterike dhe katastrofa të tjera (p.sh, ngjarje me frekuencë të ulët). Shoqëria konsideron që detyrimi për dëmet jo-jetë të njohura në pasqyrën individuale të pozicionit financiar është i mjaftueshëm.



6.4 Dëmet në shoqërinë Albsig Sh.a.

Shpenzimet për trajtimin e dëmeve gjatë vitit 2024 janë në vlerën 65,875,874 lekë (2023: 78,109,054 lekë). Në tabelën 9 jepet historiku i dëmeve të paguara bruto nga Shoqëria Albsig sh.a. përsa i përket kohës së pagesës së dëmeve është si më poshtë.

Në mijë lekë	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	Total
Në fund të vitit të aksidentit	58,208,588	134,028,477	211,779,945	426,536,551	551,717,404	328,985,861	512,933,043	456,977,250	886,000,728	749,227,965	4,316,395,812
1 vit më vonë	57,535,792	76,428,319	138,705,926	141,047,174	1,226,352,834	107,102,568	156,149,540	183,839,521	340033327.8		2,427,195,002
2 vite më vonë	25,963,752	39,859,348	22,952,506	34,938,669	197,156,743	26,616,237	47,280,825	48456341.43			443,224,421
3 vite më vonë	10,236,084	15,082,394	10,250,756	8,286,691	100,895,694	15,280,859	54141276.75				214,173,755
4 vite më vonë	3,286,592	81,329,978	4,344,723	18,970,163	86,779,520	7587420.756					202,298,397
5 vite më vonë		254,896	23,709,089	2,806,658	13235040						40,005,683
6 vite më vonë		4,861,530	243,412	72827.3							5,177,769
7 vite më vonë	2,680,929	687,981	326589.98								3,695,500
8 vite më vonë											
9 vite më vonë											
Kumulative	157,911,737	352,532,923	412,312,947	632,658,733	2,176,137,235	485,572,946	770,504,685	689,273,112	1,226,034,056	749,227,965	7,652,166,338

✓ Risku i Administrimit të kapitalit

Strategjia e shoqërisë në lidhje me rrezikun e kapitalit nuk ka ndryshuar. Struktura kapitale e shoqërisë konsiston në kapitalin aksionar të shoqërisë që përbëhet nga kapitali themeltar, rezervat dhe fitimet e mbartura. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar nivelin e duhur të kapitalit në mënyrë që të jetë e aftë të vazhdojë në vijimësi dhe të përmbushë kërkesat rregullore të kapitalit, ndërkohë që maksimizon kthimin tek aksionaret nëpërmjet optimizimit të gjendjes së detyrimeve dhe kapitalit. Më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 aksionet e kapitalit të Shoqërisë janë në përputhje me kërkesat dhe rregullat për sigurimet, për kapitalin aksionar.

✓ Risku i Reputacionit

Në një epokë të rritur të vëzhgimit në media sociale, risqet e reputacionit ngritën sfida të mëdha për siguruesit. Protokollet e reagimit të shpejtë, angazhimi proaktiv i palëve interesante dhe strategjitë e komunikimit transparent u përdorën për të adresuar të metat e klientëve menjëherë, për të zbutur publikitetin negativ dhe për të ruajtur reputacionin e markës, duke nxitur besimin dhe besnikërinë e të siguruarve.

✓ Risku ligjor

Ndryshimet legjislative në segmentet e biznesit në të cilat operon shoqëria mund të ndikojnë tek fitimet. Aktiviteti i sigurimeve është objekt i mbikëqyrjeve gjithëpërfshirëse e në zhvillim e sipër në Shqipëri. Qëllimi kryesor i legjislativit është mbrojtja e të siguruarve. Ekipet e dedikuara monitoruan zhvillimet ligjore, duke siguruar zbatimin kohor të masave të kërkuara dhe angazhimin proaktiv me autoritetet rregullore për të parashikuar kërkesat e ardhshme, duke zbutur rreziqet e zbatimit të ligjit dhe duke nxitur një kulturë të përputhshmërisë me ligjin.

✓ Risku Klimatik dhe Katastrofik

Rritja e frekuencës dhe rëndësisë së katastrofave natyrore nënvizoi urgjencën e menaxhimit të rrezikut klimatik. Siguruesit integruan vlerësimet e riskut klimatik në vendimet e nënshkrimit dhe investimeve, duke bashkëpunuar për modelimin e saktë dhe duke promovuar iniciativat e qëndrueshme për të zbutur risqet e lidhura me klimën, duke siguruar reziliencë afatgjatë përpara sfidave mjedisore..

✓ Risku nga kurset e këmbimit

Risku i normave të interesit është i ndikuar nga risku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në tregun e normave të interesit dhe risku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli risku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut. Shoqëria mban një shumë jo të konsiderueshme të detyrimeve interes mbartëse dhe risku i shkaktimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit nuk është domethënës. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse. Primet janë shprehur në tre valuta kryesore (LEK, USD dhe EURO). Tabela e mëposhtme paraqet një analizë sasiore të rrezikut valutor të shoqërisë më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023:

		2024	2023
	Ndikimi	në Lek	në Lek
EUR rritet me 5% ndaj Lekut	Fitim	1,064,468	7,261,981
EUR ulet me 5% ndaj Lekut	Humbje	(1,064,468)	(7,261,981)
USD rritet me 5% ndaj Lekut	Fitim	8,072,248	6,603,004
USD ulet me 5% ndaj Lekut	Humbje	(8,072,248)	(6,603,004)

✓ Risku Operacional

Kërcënime të sigurisë kibernetike vazhduan të zhvilloheshin në sofistikim, duke paraqitur rreziqe operacionale të rëndësishme. Siguruesit i kushtuan investimet në infrastrukturën e sigurisë së fuqishme kibernetike, testimet e vazhdueshme të penetrimit dhe programet e trajnimit të hollësishëm të punonjësve për të zbutur kërcënimin e rritur të sulmeve kibernetike, duke mbrojtur të dhënat e ndjeshme dhe duke siguruar operacione të pa ndërprera të biznesit. Përdorimi më efikasitet i sistemit të shitjes, administrimit, dëmeve dhe financës ka minimizuar shumë risqe duke bërë të mundur një harmonim më të mirë midis kontrollit dhe raportimit. Analizat aktuariale ndikojnë në aplikimin e metodave më të mira aktuariale për llogaritjen e provigjoneve të dëmeve (IBNR) dhe për kontrole më të forta mbi të dhënat nga Aktuari, sidomos të dëmeve shëndetësore të TPL, të cilat kanë luhatje në vlerësime, por që në shoqërinë Albsig sh.a. trajtohen dhe mbyllen brenda një kohe sa më të shkurtër dhe në bazë të kërkesave ligjore në fuqi.

Për këtë Departamenti i Dëmeve bashkëpunon me Departamentin Juridik dhe Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe IT për marrjen e informacionit të plotë dhe në kohë për të gjitha rastet e ndodhura të dëmeve për tu raportuar saktë për efekt të provigjoneve teknike të dëmeve si dhe azhurnimi i dëmeve në proces gjyqësor me vendimet e gjykatave në periudhat që raportohen dhe në zbatim të "Procedura për trajtimin e dëmeve sipas statuseve të tyre dhe rakordimi ndërmjet departamenteve përkatëse". Testimi i provigjonimit të dëmeve është bërë nëpërmjet analizës RUN-OFF të dëmeve. Kjo analizë është bërë për dëmet e ndodhura dhe të raportuara (RBNS) në shoqëri dhe për dëmet e ndodhura dhe nuk janë të raportuara (IBNR). Teste për vlerësimin e provigjoneve të dëmeve në 31.12.2023 për sigurimin e detyrueshëm motorik TPL, Karton jeshil, Kufitare dhe Kasko dhe Total janë bërë në mënyrë të vazhdueshme në periudhat në vazhdim duke marrë rezultate pozitive.



✓ Risku i Likuiditetit

Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti. Shoqëria e sigurimit konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 6 të rregullores "Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit", është më i lartë ose i barabartë me 1 (një). Për qëllim të monitorimit të likuiditetit shoqëria bën monitorimin e fluksit të parasë në mënyrë periodike duke u bazuar në llogaritjet me bazë ditore të normës së likuiditetit dhe është më i lartë se 1 (një).

6.5 Kuadri i Administrimit të Riskut

Shoqëria Albsig Sh.a. mbikëqyret dhe kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve dhe Këshilli Mbikëqyrës. Kompetencat e këtyre organeve drejtuese përcaktohen në Statutin e Shoqërisë dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore. Albsig Sh.a. ka vendosur objektiva të qarta për periudhën 1-vjecare dhe 3-vjecare dhe rritja e sigurisë për arritjen e tyre kërkon menaxhimin e realizimit të objektivave. Kjo kërkon vendosjen dhe zotërimin e një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të riskut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj risqeve me të cilat përballlet shoqëria. Këtu merr kuptim Politika e Menaxhimit të Riskut e cila kërkon që të shqyrtohet jo vetëm natyra e risqeve, por dhe kuptimi i koncepteve kryesore të menaxhimit të riskut. Çdo njësi e qeverisjes duhet të përgatisë dhe të miratojë një strategji të menaxhimit të riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht (të paktën një herë në vit) si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme.

6.6 Administrimi i kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese

Shoqëria ka objektiv kryesor që niveli i kapitalit që do mbajë do të jetë sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Shoqëria do ruajë një nivel marzhi 250% ndaj kufirit minimal të kërkuar të kapitalit, sipas metodës me bazë primet ose dëmet, si dhe do synojë gradualisht dhe mbajtjen e një niveli të paktën 150% të fondit të garancisë. Kjo strategji do të jetë ruajtja e kërkesave rregulatore në çdo kohë, përdorimi eficient i kapitalit, nëpërmjet analizës së vazhdueshme të treguesve të performancës. Duke patur parasysh kërkesat e legjislacionit në fuqi për nivelin e kapitalit është testuar në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet skenarëve të stresit, për të bërë të mundur zbutjen e risqeve që dobësojnë fuqinë e kapitalit. Shoqëria ka testuar, duke bërë provën e rezistencës mbi bazën e shumës së siguruar, pasi nuk ka të dhëna publike në lidhje me probabilitetet dhe dëmet e ndodhura nga katastrofat natyrore në vendin tonë. Në fund të vitit 2024 vlera e fondit të garancisë është brenda të gjitha normave të kërkuara ligjore.

6.7 Aktive në mbulim të provigjoneve teknike

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" si dhe rregullores nr. 19 "Për aktivet në mbulim të provigjoneve teknike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve" aktivet në mbulim të rezervës teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 gusht 2008. ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematikore se përqindjet si më poshtë. Aktivet që mbulojnë rezervën teknike për periudhën e fund vitit 31 Dhjetor 2024:

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt
1.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	9,815,000
1.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%	122,000,000
1.10	g) Hua të pasiguruara dhe hua të siguruara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruase në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë ;	10%	182,774,748

I.11	gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14:	30%	2,006,762,591
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	1,588,978,182
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	1,588,978,182
II.	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:		-
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4:		1,842,324,096
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	105,866,477
III.5	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%	54,428,204
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjonit të primit të pafituar;	20%	261,352,394
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	154,999,880
III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	53,234,828
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartanit jeshil pranë BSHS	100%	6,140,509
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	1,206,301,804
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		5,752,654,617
V	TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		4,208,661,426
VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		3,973,553,878
VI.1	Provigjone të primit të pafituar		2,888,848,175
VI.2	Provigjone të dëmeve		1,084,705,703
VII	Tepicë (+) / Mungesë (-) (V-VI)		235,107,548
VIII	Mbulimi në % (V/VI)		105.92%

6.8 Marzhi i Aftësisë Paguese

Sipas vendimit nr. 191 datë 25.03.2005 "Për miratimin e metodikës: Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbejnë atë" koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje

b1 = koeficienti i pasigurisë. duke marrë në konsideratë shumën "a" është 0.18

b2 = koeficienti i pasigurisë. i llogaritur duke marrë në konsideratë "a2" është 0.16.

Sipas nenit 80 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" niveli i kërkuar i Aftësisë Paguese të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370.000.000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë paguese.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj është si më poshtë:

	Kufiri minimal i Aftësisë paguese, Jo Jetë	ALBSIG SH.A.	31.12.2024
1	Llogaritja me bazë primet		
2	Prime të shkruara nga aktiviteti i sigurimeve	4,313,201,807	leke
3	Prime të shkruara nga aktiviteti i risigurimeve	-	leke
4	Taksa të zbritshme	208,472,647	leke
5	Shuma "a" (5=2+3-4)	4,104,729,160	leke
6	Pjesa e shumës "a" më e vogël se 1,000,000,000 lekë (6=min(1,000,000,000,5))	1,000,000,000	leke
7	Pjesa e shumës "a" më e madhe se 1,000,000,000 leke (7=5-6)	3,104,729,160	leke
8	Koeficienti i pasigurisë a1 (8=0.18)	0.18	
9	Koeficienti i pasigurisë a2 (9=0.16)	0.16	
10	Total (10=6*8+7*9)	676,756,666	leke
11	Dëme të paguara bruto	1,275,022,313	leke
12	Pjesa e risiguresit në dëmet e paguara	141,741,948	leke
13	Deme të paguara neto (13=11-12)	1,133,280,364	leke
14	Provigjone bruto të dëmeve në periudhën aktuale	1,084,010,631	leke
15	Provigjone bruto të dëmeve në fund të vitit të kaluar	872,309,218	leke
16	Pjesa e risiguresve ne provigjonet e dëmeve ne periudhen aktuale	-	leke
17	Pjesa e risiguresve ne provigjonet e dëmeve ne fund te vitit te kaluar	8,300,000	leke
18	Provigjone neto te dëmeve ne periudhen aktuale (18=14-16)	1,084,010,631	leke
19	Provigjone neto te dëmeve ne fund te vitit te kaluar (19=15-17)	864,009,218	leke
20	Ndryshimi ne provigjonet e dëmeve bruto (20=14-15)	211,701,413	leke
21	Ndryshimi ne provigjonet neto te dëmeve (21=18-19)	220,001,413	leke
22	Deme te ndodhura bruto (22=11+20)	1,486,723,725	leke
23	Deme te ndodhura neto (23=21+13)	1,353,281,777	leke
24	Raporti i mbajtjes (24=max(0.5 , 23/22))	0.9102	
25	Rezultati nga llogaritja me baze primet (25=24*10)	615,983,917	leke
26	2. Llogaritja me baze demet		
27	deme te paguara bruto ne vitin e pare	885,314,974	leke
28	pjesa e risiguresit ne demet e paguara ne vitin e pare	79,567,285	leke
29	deme te paguara neto ne vitin e pare (29=27-28)	805,747,689	leke
30	deme te paguara bruto ne vitin e dyte	1,303,485,215	leke
31	pjesa e risiguresit ne demet e paguara ne vitin e dyte	332,129,511	leke
32	deme te paguara neto ne vitin e dyte (32=30-31)	971,355,704	leke
33	deme te paguara bruto ne vitin e trete	1,275,022,313	leke
34	pjesa e risiguresit ne demet e paguara ne vitin e trete	141,741,948	leke
35	deme te paguara neto ne vitin e trete (35=33-34)	1,133,280,364	leke
36	provigjone bruto te dëmeve ne fund te vitit te pare	780,700,234	leke

37	provigjone neto te demeve ne fund te vitit te pare	752,467,083	leke
38	Totali i demeve te ndodhura (38=27+30+33-36+14)	3,767,132,899	leke
39	Shuma "b" deme te ndodhura/3 (39=38/3)	1,255,710,966	leke
40	Pjesa e shumes "b" me e vogel se 750,000,000 leke (40=min{750,000,000, 39})	750,000,000	leke
41	Pjesa e shumes "b" me e madhe se 750,000,000 leke (41=39-40)	505,710,966	leke
42	Koeficienti i pasigurise b1 (42=0.26)	0.26	
43	Koeficienti i pasigurise b2 (43=0.23)	0.23	
44	Total (44 = (40*42) + (41*43))	311,313,522	leke
45	Totali i demeve te ndodhura bruto (45=38)	3,767,132,899	leke
46	Totali i demeve te ndodhura neto (46=29+32+35-37+18)	3,241,927,305	leke
47	Raporti i mbajtjes (47=max{0.50, 46/45})	0.86	
48	Rezultati nga llogaritja me baze demet:(48=44*47)	267,729,629	leke
49	Kufiri minimal i Aftesise Paguese (49= max{48,25})	615,983,917	leke

Marzhi i aftësisë paguese duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 dhjetor 2024 përbëhet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	2,096,284,170
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;	879,460,000
I.c	Fitimi i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	1,220,017,797
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç)	3,193,628
II.b	Investimet në aktive të patrupëzuara	3,193,628
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	839,545,523
IV.a	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	432,254,000
V	Aktivet jolikuide (V.a deri V.g)	407,291,523
V.a	Aksionet e palistuar në tregje të rregulluara	
V.b	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura	182,774,748
V.c	Huatë nga brokerat dhe agjentët	
V.ç	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90- ditor;	143,774,620
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	74,601,645
V.h	Elementë të tjerë të zbritshëm sipas nenit 4 të kësaj rregullore (V.-h-1 deri V.h-10) :	6,140,509
V.h-9	Fondi i Garancisë për Kartonin Jeshil	6,140,509
VI	KAPITALI (Aftësia Paguese)	1,256,738,647
VII	Kufiri minimal i aftesise paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	615,983,917

VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	923,975,876
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	332,762,772
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm

6.9 Testi i rezultateve të marrjes në sigurim

Duke u bazuar në një analizë 3-vjecare 2022-2024 dhe tek testi i rezultateve të marrjes në sigurim sipas portofoleve si më poshtë për vitin 2024:

- **Portofoli i Aksidenteve dhe shëndeteve** ka një rritje të raportit dëme/prime neto nga 2024 në 2023. Konstatohet se është raport i lartë i shpenzimeve, jashtë diapazonit normal, por ka ulje krahasuar me vitin 2023. Raporti i shpenzimeve, vecanërisht i marrjes në sigurim do të vazhdojë të monitorohet me kujdes në të gjitha elementet përbërëse të tij nga menaxherët e marrjes në sigurim të këtij portofoli që të jetë në normat e duhura.
- **Produkti Kasko** është në përgjithësi produkt me risk shumë të lartë që do menaxhohet me shumë kujdes. Është bërë e ditur për menaxherin e këtij produkti për ta monitoruar më me kujdes në mënyrë të tillë që ky raport në të gjitha elementet përbërëse të tij, të mos rezultojë me humbje. Për këtë produkt janë bërë analiza të vazhdueshme gjatë vitit, analiza totale për produktin dhe në nivel subjekti të siguruar. Si rrjedhojë i monitorimit dhe analizave të vazhdueshme ky produkt ka përmirësuar. Produkti Kasko ka raport të kombinuar me ulje në krahasim me vitin 2023.
- **Sigurimi i detyrueshëm motorik** pëmonitorohet përsa i përket komisioneve të ndërmjetësimit që të jenë në përputhje me kërkesat e rregullores në fuqi dhe raporti i shpenzimeve ka ulje krahasuar me vitin 2023. Raporti dëme / prime neto për vitin 2024 ka patur rritje krahasuar me 2023.
- Edhe për sigurimin e detyrueshëm motorik u është rekomanduar menaxherëve të marrjes në sigurim të këtyre produkteve që ta monitorojnë me kujdes raportin e shpenzimeve, vecanërisht të marrjes në sigurim që të vijë në normat e lejuara.
- **Portofoli i Pronës** (Zjarr dhe rreziqe shtesë, Mall gjatë transportit, Vjedhja, Sigurimi inxhinierik, Garancitë) nga analiza rezulton që e ka tepër të lartë raportin e shpenzimeve jashtë diapazonit normal, por me ulje krahasuar me vitin 2023. Për këtë arsye, ky raport vazhdon të monitorohet me kujdes nga menaxherët e marrjes në sigurim që të jetë në normat e duhura.
- **Sigurimi i Përgjegjësisë Civile** nga analiza rezulton që e ka tepër të lartë raportin e shpenzimeve jashtë diapazonit normal. Për këtë arsye, ky raport vazhdon të monitorohet me kujdes nga menaxherët e marrjes në sigurim që të jetë në normat e duhura.

Përfundime:

- Teste të rezultateve sipas linjave të sigurimit janë bërë në mënyrë periodike nga të cilat është vërejtur se është përmirësuar raporti i shpenzimeve për linja të vecanta.
- Në total kemi rritje të raportit të dëme / prime neto nga 29% në vitin 2022 në 31% në vitin 2023 dhe 34% në vitin 2024 dhe ulje të raportit të shpenzimeve nga 60% në vitin 2023 në 57% në vitin 2024.
- Raporti i kombinuar në vitin 2024 është 91% në të njëjtin nivel në krahasim me vitin 2023.

6.10. Toleranca dhe kufijtë e riskut

Toleranca ndaj riskut përcaktohet nga objektivat strategjike të shoqërisë. Objektivat strategjike të shoqërisë janë të lidhura kryesisht me objektivat e rritjes në treg, marzhet e synuara të fitimit dhe mbajtjen e një niveli kapitali mbi një marzh të caktuar. Në këto objektiva është përcaktuar si qëllimi i pozicionimit në treg në pjesëmarrje, ashtu dhe në raport me cilësinë e shërbimit.

Matësit e nivelit të riskut që përdoren kryesisht janë kufijtë gjatë procesit të marrjes në sigurim, si për ekspozimet individuale ashtu dhe për ekspozimet agregate sipas linjave të sigurimit. Shoqëria ka manual dhe procedura të hartuara për këtë qëllim. Shoqëria zbaton marrëveshje risigurimi treaty, fakultative në mbrojtje të kapitalit. Një nga risqet më të rëndësishme të matshme nga ana sasiore, ndaj të cilit mund të përdoren strategjitë e zbutjes është vlerësuar risku i katastrofave. Shoqëria Albsig sh.a., është në proces të rishikimit dhe ndërtimit të politikave të ndryshme të cilat janë cituar dhe në planin e menaxhimit të riskut të miratuar në Këshillin Mbikëqyrës të Shoqërisë.

Primet nga biznesi i Pronës vijnë në mënyrë vullnetare dhe nga kanalet bankare. Zbutja e këtij risku kryhet nëpërmjet risigurimit, si mekanizmi kryesor i transferimit të këtij risku, pasi risqet bazë për produktin Zjarri dhe rreziqe shtesë me përfitues bankat e nivelit të dytë janë Zjarr dhe Tërmet. Marrëveshjet e risigurimit janë nënshkruar vetëm me shoqëritë e risigurimit që përmbushin kushtet dhe kriteret sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

6.11. Kufijtë për risigurim 2024

Në lidhjen e kontratave të risigurimit, shoqëria do të shfrytëzojë kapacitetin e konsiderueshëm teknik dhe financiar. Mbajtja e shoqërisë për çdo risk do të jetë brenda limiteve të përcaktuara sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi, ndërsa risiguruesit do të përzgjidhen nga tregu European dhe Botëror i risigurimeve, ku përfshihen:

- Swiss Re,
- Hannover Re,
- Scor,
- Trust Re,
- Polish Re, etj.

Përfundime:

- Shëndeti financiar dhe marrëdhëniet shumë të mira të bashkëpunimit me tregun ndërkombëtar të risigurimeve i garantojnë shoqërisë Albsig Sh.a. besueshmëri të plotë në përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër. Edhe këtë vit në risigurimin e Pronës, Aksidenteve, Përgjegjësive dhe Kaskos shoqëria do të operojë nëpërmjet ndërmjetësimit të brokerit AON, që do të sjellë për shoqërinë rritje të ekspertizës përsa i përket përzgjedhjes së mbulimeve, limiteve apo risiguruesve që do të jenë pjesë e kontratave të risigurimit.

Identifikimi dhe vlerësimi i riskut dhe kontrollit, duhet të marrë masat e duhura sipas nevojës. Ka një numër të mënyrave të cilat mund të përgjigjen ndaj riskut, duke përfshirë:

- Transferimi i një pjese të riskut; për shembull, duke blerë sigurim ose risigurim;
- Trajtimin ose zbutje të riskut; dmth të zvogëlojë gjasat dhe/ose ndikimit të tij;
- Të pranojë ose të tolerojë nivelin aktual të riskut, ku risku i afrohet apo është në kufijtë e tolerancës së riskut. Kjo mund të jetë e përshtatshme ku zbutja e nivelit aktual të riskut është në disproporcion me përfitimet.
- Eliminimin ose përfundimin;
- Nivelet e oreksit të riskut në ndryshimin apo tolerimin e shkëlqes për një kohë të shkurtër (në këtë rast arsyetimi duhet të dokumentohet). Kur përcaktimi i përshtatshmërisë së përgjigjeve të riskut konsiderohet si në vijim:
- Fizibiliteti dhe kostot relative (direkte, indirekte dhe mundësitë) dhe përfitimet e opsioneve alternative të reagimit të riskut, kostoja për të hartuar dhe zbatuar një kontroll të ri dhe kostoja në vazhdimësi e kontrollit;
- Aspektet cilësore të riskut, të tilla si ndikimi mbi riskun e reputacionit;
- Nevojën për të siguruar që përgjigjet janë bazuar në një kuptim të plotë të riskut dhe komponentëve të tij, veçanërisht shkaqet e riskut, për të siguruar ato që janë të adresuara;
- Nëse risqet nuk mund të kontrollohen për nivele të pranueshme duhet të shmangen, ose plane të vazhdimësisë së zhvillimit të krijohen.

Në programin e Administrimit të Riskut identifikimi i risqeve është komponenti kryesor dhe ka për qëllim identifikim e të gjitha risqeve të rëndësishme me të cilat përballlet shoqëria. Shoqëria fokusohet tek risqet kryesore, të cilat pengojnë arritjen e objektivave strategjike.

Këto risqe janë pjesë e procesit të administrimit të riskut për periudhën. Pjesë e procesit të administrimit të riskut janë dhe risqet që lidhen me veprimtarinë e përditshme. Risqet e pranishme në shoqëri janë të përfshira në një prej kategorive të identifikuar më poshtë

7.1 Kontrollat e brendshme

Aktivitetet e kontrollit¹ veprojnë në të gjitha nivelet brenda shoqërisë për të zbutur risqet në nivele të pranueshme. Kontrollat mund të përfshijnë politikat, procedurat, sistemet dhe proceset për të gjithë shoqërinë. Kontrollat efektive janë zakonisht:

- Të përshtatshme dhe në proporcion me risqet kryesore me të cilat përballen në të gjitha nivelet, në mënyrë që të sigurojnë kosto në zbutjen e riskut të efektshme;
- Një pjesë normale e veprimtarisë së përditshme, sistemet dhe procedurat e menaxhimit dhe proceset vendimmarrëse të të gjithë biznesit;
- Koordinuar në të gjithë shoqërinë;
- Nënshirohen vlerësimit të rregullt (p.sh. janë kontrollat efektive në zbutjen e risqeve kryesore),
- Nënshirohet një procesi të sigurimit të përgjithshëm, i cili gjithashtu adreson mjedisin më të gjerë të kontrollit.

¹ Aktivitetet e kontrollit përfshijnë: aktivitete kontrolli parandaluese: të cilat synojnë uljen e mundësisë së një rezultati të padëshiruar, si p.sh. ndarja e detyrave mes stafit të një drejtorie ku çdo punonjës nuk vepron për një vendimmarrje të caktuarpa miratimin e një punonjësi tjetër etj.; aktivitete kontrolli korrigjuese: të cilat synojnë korrigjimin e rezultateve të padëshiruara dhe parashikojnë mënyrat për ndreqjen e dëmeve të shkaktuara aktivitete drejtuese të konceptuara për arritjen e një rezultati të caktuar e kërkuara që i mundëson të punojë i pambikëqyrrur; aktivitete kontrolli zbuluese të konceptuara për të identifikuar rastet kur rezultatet e padëshiruara tashmë kanë ndodhur (p.sh. kontrole të provigjoneve, aktiveve apo procedurave të rakordimit).

Mjedisi i kontrollit përfshin qasjen e qeverisjes, stilin e menaxhimit, strukturën organizative dhe kulturën e gjerë brenda të cilit kontrollojnë aktivitete që zhvillohen. Kontrollat shpesh janë kategorizuar në dy lloje:

- **Pak përfshirëse** – Kontrolle që zvogëlojnë gjasat e një ngjarje të riskut që ndodh. Planifikimi dhe strategjia e vendosjes, autorizimi dhe të dhënat hyrëse të kontrollit
- **Zbuluar** – kontrole që identifikojnë dukuritë e ngjarjeve të riskut, pasi ato kanë ndodhur dhe për të mundësuar veprime korrigjuese që duhen ndërmarrë për të kufizuar shkallën e dëmtimit, p.sh. Alarme përjashtimi dhe raportimi, si dhe shqyrtimet e rezultateve aktuale kundrejt pritjeve.

Vlerësimi i riskut do të duhet të marr në konsideratë efektivitetin me të cilën kontrollon riskun e zbutur. Një metodë është të marrin në konsideratë hartimin e një kontrolli dhe performancën e saj:

- **Dizajni** – konsideron si edhe kontrolli duhet të punojë në qoftë se është zbatuar gjithmonë në mënyrën se si ajo është menduar për të punuar;
- **Performanca** – konsideron mënyrën në të cilën kontrolli është operuar në praktikë; në qoftë se është aplikuar kur duhet të jetë dhe në mënyrën e synuar nga projektuesi i saj

7.2. Ngritja e reputacionit për të zgjeruar bazën konkurruese.

Shoqëria përzgjedh dhe monitoron me kujdes të gjithë stafin e saj që është në kontakt me klientët, për të kënaqur pritshmëritë e klientëve në të gjitha linjat e biznesit ku shoqëria operon, sepse kontaktet e para me klientët janë shumë të rëndësishme. Ky element do të jetë në përmirësim të vazhdueshëm, pasi ndikon në arritjen e objektivave strategjike të shoqërisë. Shoqëria fokus të vecantë i jep risqeve kryesore, por edhe risqeve të tjera që mund të ndërveprojnë me risqet kryesore.



Stres-testet janë përgjithësisht përcaktuar duke iu referuar lëvizjeve në parametrat financiarë kryesorë (të tilla si normat e interesit, vlera e aktiveve ose vlerat e detyrimit), ndërsa testet e skenarëve mund t'u referohen shkaqeve të zhvillimeve negative, të tilla si katastrofat materiale natyrore apo incidentet më të mëdha industriale.

Stres-testet duhet të jenë të përshtatura në profilin e tyre të riskut. Për këtë qëllim, duhet të identifikojmë risqet e mundshme afatshkurtra dhe afatgjata dhe ngjarjet e mundshme apo ndryshimet e ardhshme në kushtet ekonomike që mund të kenë një efekt të pafavorshëm në gjendjen e përgjithshme financiare për të përcaktuar ndikimin tek kapitali.

Analizat e skenarëve bazohen në një sërë ngjarjesh, duke përfshirë ngjarjet ekstreme, por të mundshme dhe të marrë parasysh ndonjë efekt material të cilat mund të lindin. Stres-testet janë ato që kërkojnë të vlerësojnë skenarët dhe rrethanat që do të bëjnë modelin e biznesit të paqëndrueshem, duke identifikuar dobësitë e mundshme të biznesit

Testimi i stresit të kundërt fillon nga një rezultat i modelit të biznesit dhe identifikon rrethanat në të cilat kjo mund të ndodh.

- **Risku i sigurimit:** një tërmet, përmbytje në zonat ku shoqëria ka ekspozim të madh ndaj tyre;
- **Risku i kreditit:** dështimi i një risiguruesi dhe/ose banke me ekspozim të lartë;
- **Risku operacional:** përzgjedhja e metodës së provigjonimit të dëmeve dhe ndikimi i diferencave me rezultatin e metodës së audituesit të pavarur, probleme me sistemin e shitjes së kontratave të sigurimit;
- **Risku i tregut:** zhvlerësim i monedhës Lekë ndaj monedhave të huaja Euro, Dollarë;
- **Risku i likuiditetit:** mosrinovim në masën 30% të kontratave në një nga portofolet kryesore si prona dhe MTPL.

8.1 Vetëvlerësimi i riskut, ORSA

Orsa mund të përkufizohet si tërësia e proceseve dhe procedurave të përdorura për të identifikuar, vlerësuar, monitoruar, menaxhuar dhe raportuar në kohë afatshkurtër dhe riskun afatgjatë. Orsa kërkon menaxhimin për të marrë parasysh vlerësimin e tyre të risqeve dhe kapitalit të shoqëruara ekonomikisht si të nevojshme për të përmbushur objektivat strategjike.

Orsa duhet të lejojë që menaxhimi të marrë një kuptim të vërtetë dhe praktik të risqeve të ekspozuar ose mund të përballet me të ardhmen, si kapitalin dhe veprimet lehtësuese të nevojshme për të mbuluar këto risqe. Si e tillë Orsa duhet të marrë parasysh proceset e riskut, kapitalit, të performancës dhe strategjisë dhe duhet të sigurojë menaxhimin me informata të nevojshme për të marrë vendime të rëndësishme në lidhje me profilin e përgjithshëm të riskut dhe kapitalit. Orsa duhet të shihet si një proces i vazhdueshëm, e jo thjesht një pikë në raportin kohor që mbulon procesin.

Qëllimi kryesor i Orsa është që të sigurojë menaxhimin me një mekanizëm përmes të cilit Këshilli Mbikëqyrës dhe menaxhimi mund të vlerësojnë risqet me të cilat përballen për të përcaktuar nivelin e kapitalit ekonomik të nevojshëm për të përmbushur objektivat strategjike.

Përcaktimi i nevojave të përgjithshme të Aftësisë Paguese duhet të kontribuojnë në vlerësimin nëse do të mbajë apo të transferojë risqet.

Vlerësimi i Aftësisë Paguese nevojitet që:

- Të pasqyrojë praktikat e menaxhimit, sistemet dhe kontrollet, duke përfshirë përdorimin e teknikave të zbutjes së riskut;
- Të vlerësojë cilësinë e proceseve dhe inputeve, në mënyrë të veçantë përshtatshmërinë e sistemit të saj të qeverisjes, duke marrë parasysh risqet që mund të lindin nga mangësitë
- Të lidhi planifikimin e biznesit me aftësisë paguese të nevojshme
- Të përfshijë identifikimin e qartë të skenarëve të mundshme në të ardhmen;
- Të trajtojë stresin e potencialit të jashtëm

Dhe

- Të marrë parasysh veprimet e menaxhimit të cilat mund të miratohen në rrethana të vështira

8.2 Teste të paralajmërimit të hershëm

Bazuar në sistemin e treguesve të paralajmërimit të hershëm, është konstatuar se:

Raporti i mbajtjes neto është në masën 95.07 %.

Ky raport është pothuajse në të njëjtat nivele në krahasim me vitin 2023, duke qenë në nivelin e kufijve të lejuar.

Raporti i kombinuar për shoqërinë është në masën 91.17 %, tregues i rezultatit financiar pozitiv të shoqërisë në aktivitetin operacional.

Ky raport është brenda kufijve të lejuar.

Raporti dëme/prime neto për shoqërinë në 31.12.2023 është 34.31 % dhe ka rritje krahasuar me 31.12.2023 që ishte 30.86 %, sepse gjatë vitit 2024 kemi rritje të pagesave kryesisht të dëmeve TPL, Kasko dhe Pronë

Ky raport është brenda kufijve të lejuar.

Raporti i shpenzimeve në 31.12.2024 është në masën 56.86 % dhe ka ulje në krahasim me 31.12.2023 që ishte në masën 60.15%.

Ky raport tejkalon normat e përcaktuara ndërkombëtare. Peshën më të madhe në strukturën e shpenzimeve të shoqërisë e zënë shpenzimet e marrjes në sigurim të veprimtarisë, në masën 37.06 % dhe në masën 19.80 % shpenzimet administrative të veprimtarisë së shoqërisë

Përfundime:

Shoqëria Albsig sh.a. do të monitorojë me kujdes të madh të gjitha elementet që përbëjnë shpenzimet administrative dhe pavarësisht konkurrencës së fortë në treg për marrjen në sigurim do të monitorohen me kujdes të gjitha elementet e shpenzimeve të marrjes në sigurim.

8.3. Planet e vazhdueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara.

Plani i vijueshmërisë së veprimtarisë dhe përballimit të situatave të paparashikuara vlerësohen nga shoqëria Albsig sh.a. si një risk, i cili duhet administruar me shumë kujdes, nisur nga varësia ndaj sistemeve të IT. Për këtë bëhet rishikimi një herë në vit i planit të vijueshmërisë së veprimtarisë.

Shoqëria i jep rëndësi këtij risku, sepse në rastin e një katastrofe duhet të garantojë vazhdimësinë operacionale të saj dhe ti përgjigjet në kohë dhe shpejtësi kërkesave të klientëve për dëmshpërblim. Shoqëria e ka në objektivin e saj për përmisime cilësore të mëtejshme në lidhje me sistemet dhe investimet në sisteme. E rëndësishme është për të qënë në monitorim të qëndrueshëm për të gjitha fushat e riskut. Për këtë shoqëria është gjithmonë fokusuar në ndërmarrjen e masave për eliminimin apo pakësimin e riskut në nivelin e pranueshëm. .

Shoqëria Albsig sh.a. gjithmonë ka një parim se menaxhimi i Riskut është një balancim i një numri elementesh të ndërthurur të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët kërkojnë që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duke qënë në ekuilibër me njëri tjetrin.

Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se një risku të vetëm duke bërë të vështirë të jenë njëkohësisht dhe të arritshëm.

Shoqëria është e fokusuar në një raportim efektiv të informacionit kyç të riskut të qeverisjes për të siguruar që personat e përfshirë të kenë të gjithë informacionin e nevojshëm për të marrë në konsideratë në procesin e vendimmarrjes. Për risqet që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afat-gjatë veprimi. Nëse risku mund të ndikojë në aktivitetin e dy, ose më shumë drejtorive, ky plan duhet të miratohet nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë.

Në përfundim të këtij dokumenti është hartuar edhe plani i veprimit i përcaktuar për minimizimin e risqeve të evidentuara si prioritare.

9.1 Opinioni i Auditorit të Jashtëm



RSM ALBANIA
Rr. Skender Luarasi, sheshi Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESVE TË PAVARUR

Për Aksionerin e Shoqërisë Albsig sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë Albsig sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabillisteve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare individuale për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë audituar nga një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra financiare të individuale në 4 qershor 2024.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD
ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K. is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare individuale, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomaliave materiale të pasqyrave financiare individuale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.



- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijmësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare individuale ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare individuale paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.


Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e skeduleve shoqëruese plotësuese të Aftësisë Paguese dhe Aktiveve për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("skedule plotësuese") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar skedulet plotësuese shoqëruese. Këto skedule plotësuese të përgatitura nga Drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare individuale. Informacioni historik financiar, i paraqitur në skedulet shitesë të këtyre pasqyrave financiare individuale, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.



Tiranë, 25 prill 2025



9.2. Pasqyra individuale e pozicionit financiar

Albsig sh.a

Pasqyra individuale e pozicionit financiar

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Aktivet			
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	6	105,866,477	114,122,908
Investime	7	2,144,028,011	2,220,290,292
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8	405,127,014	382,607,140
Aktive të lidhura me risigurimin	9	54,428,204	68,397,917
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	191,736,068	127,973,921
Aktive të tjera	11	71,780,834	79,471,189
Tatim fitimi i parapaguar	32	-	15,966,076
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12	1,206,301,804	1,191,822,883
Aktive afatgjata materiale	13	1,743,321,756	1,030,035,589
Aktive afatgjata jomateriale	14	3,193,626	2,472,957
E drejta e perdorimit të aktivitetit	15	65,637,762	-
Aktive materiale të mbajtura për shitje	16	352,802,955	427,228,471
Aksione në shoqëri të lidhura	17	432,254,000	432,254,000
Totali i aktiveve		6,776,478,511	6,092,643,343
Kapitali			
Kapitali aksionar	18	879,460,000	879,460,000
Fitime të mbartura		912,907,137	812,342,203
Fitimi i ushtrimit		307,110,659	210,564,934
Totali i kapitalit		2,099,477,796	1,902,367,137
Detyrimet			
Rezerva teknike për dëmet	19	1,084,705,703	872,309,218
Rezervat e primit të pafiturar	20	2,888,848,176	2,740,556,241
Llogari të pagueshme për risigurimet	21	41,203,658	51,031,914
Detyrime ndaj paleve të lidhura	22	72,387,685	11,245,615
Tatim fitim i pagueshëm	32	6,452,080	-
Detyrime për qera	23	67,587,143	-
Detyrime të tjera	24	515,816,270	515,133,218
Totali i detyrimeve		4,677,000,715	4,190,276,206
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		6,776,478,511	6,092,643,343

Shënimet nga faqja 5 në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

9.3. Pasqyra individuale e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Albsig sh.a

Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Prime të shkruara bruto	25	4,313,201,807	4,090,102,319
Ndryshimi në rezervën e primit të pafituar	20	(148,291,935)	(364,312,066)
Të ardhura bruto nga primet e sigurimit		4,164,909,872	3,725,790,253
Prime të ceduara në risigurim	26	(212,827,509)	(223,975,379)
Ndryshimi në rezervën e primit pafituar të risiguruesit	9	(5,669,713)	7,797,151
Të ardhura neto nga primet e sigurimit		3,946,412,650	3,509,612,025
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	27	40,912,765	38,499,478
Të ardhura nga interesi	28	60,151,184	32,633,909
Të ardhura të tjera		3,715,348	5,550,241
Të ardhura të tjera		104,779,297	76,683,628
Të ardhurat neto		4,051,191,947	3,586,295,653
Dëme të paguara të sigurimit	19	(1,275,022,313)	(1,303,485,215)
Dëme të paguara nga risiguruesi	19	141,741,948	332,129,511
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të sigurimit	19	(212,396,485)	(91,608,984)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risigurimit		(8,300,000)	(19,933,151)
Dëme të sigurimit neto		(1,353,976,850)	(1,082,897,839)
Kostot e marrjes në sigurim	29	(1,462,419,881)	(1,371,679,368)
Shpenzimet administrative	30	(671,332,453)	(651,279,678)
Shpenzime të tjera të sigurimit	31	(107,099,896)	(84,934,204)
Shpenzime financiare neto		(92,788,713)	(138,766,854)
Total shpenzime operative		(2,333,640,943)	(2,246,660,104)
Fitim/ (humbje) nga shitja e aktiveve materiale afatgjata	13	4,392,805	(1,755,308)
Fitimi i vitit para tatimit		367,966,959	254,982,402
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	32	(60,856,300)	(44,417,468)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		(60,856,300)	(44,417,468)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(121,712,600)	(88,834,936)
Fitimi i vitit		307,110,659	210,564,934
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		307,110,659	210,564,934

Shënimet nga faqja 5 në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

9.4. Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

Albsig sh.a

Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital më 31 dhjetor 2024

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

	Kapitali i aksionar	Fitimi i mbartur	Fitimi i vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2023	879,460,000	690,378,456	301,963,751	1,871,802,207
Fitimi i vitit dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	210,564,934	210,564,934
Dividente te shperndare 2022	-	(180,000,004)	-	(180,000,004)
Transferim në fitime të mbartura	-	301,963,751	(301,963,751)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	879,460,000	812,342,203	210,564,934	1,902,367,137
Fitimi i vitit dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	307,110,659	307,110,659
Dividente te shperndare 2023	-	(110,000,000)	-	(110,000,000)
Transferim në fitime të mbartura	-	210,564,934	(210,564,934)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	879,460,000	912,907,137	307,110,659	2,099,477,796

Shënimet nga faqja 5 në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më 31 mars 2025 dhe janë firmosur nga:


Z. Muharrem Bardhoci
 Drejtor i Përgjithshëm




Z. Irfan Lami
 Drejtor i Financës

9.5. Pasqyra individuale e flukseve monetare

Albsig sh.a

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare individuale për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2024

(Vlerat në Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Flukset monetare nga aktivitetet operative		
Fitimi neto para tatimit	367,966,959	254,982,402
Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	53,908,551	62,937,424
Zhvlerësim i te arketushmeve	4,291,523	19,645,916
Efekti i aplikimit të SNRF 16	1,949,381	-
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues	428,116,414	337,565,742
Ndryshimet në		
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit	8 (26,811,397)	(84,827,927)
Aktive të lidhura me risigurimin	9 13,969,713	12,136,000
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10 (63,762,147)	(10,367,467)
Aktive të tjera	11 7,690,355	30,024,987
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	12 (14,478,921)	(77,814,779)
Rezerva teknike për demet	18 212,396,485	91,608,984
Rezervat e primit të paguar	19 148,291,935	364,312,066
Llogari të pagueshme për risigurimet	20 (9,828,256)	14,870,677
Detyrime ndaj paleve të lidhura	21 61,142,070	(142,120,254)
Detyrime të tjera	22 683,052	265,030,461
Fluksi monetar gjeneruar nga veprimtaria operative	757,409,303	800,418,490
Tatimi fitimi i paguar	29 (38,438,144)	(73,598,412)
Fluksi monetar neto i gjeneruar nga veprimtaria operative	718,971,159	726,820,078
Flukset monetare nga aktivitetet investuese:		
Blerje të aktiveve afat-gjata materiale	13,15 (1,697,347,716)	(12,373,608)
Shitje e aktiveve afatgjata materiale	1,005,337,200	86,264,252
Blerje të aktiveve afat-gjata jo materiale	14 (1,507,650)	
Shitje e aktiveve afatgjata jo-materiale	28,295	60,387
Rritja në investime	7 76,262,281	(603,731,464)
Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaria investuese	(617,227,590)	(530,477,663)
Flukset monetare nga aktivitetet financiare:		
Dividenti i deklaruar	(110,000,000)	(180,000,004)
Fluksi monetar neto i përdorur në veprimtarinë financiare	(110,000,000)	(180,000,004)
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë bankë	(8,256,431)	16,342,411
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	114,122,908	97,780,497
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	105,866,477	114,122,908

Shënime nga faqja 5 në 41 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

9.6. Shënimet shpjeguese të Pasqyrave financiare individuale

Albsig sh.a
SKEDULET PLOTESUESE

(Vlerat janë në Lek)

1. AKTIVE NË MBULIM TË PROVIZIONEVE TEKNIKE

Në përputhje me nenin nr. 97 të ligjit 52 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” si dhe rregullores nr. 19 “Për aktivet në mbulim të provigjoneve tenike dhe llojet e investimeve të lejuara të këtyre aktiveve” akivet në mbulim të rezervës teknike llogaritet si në tabelën e mëposhtme. Gjithashtu në përputhje me Vendimin e Qeverisë nr. 96 datë 03 gusht 2008. ndryshuar me vendimin nr. 5 datë 7 janar 2009; shoqëritë e sigurimit nuk mund të investojnë më shumë në aktive dhe në rezerva teknike dhe matematikore se përqindjet si më poshtë. Aktivet që mbulojnë rezervën teknike për periudhën e fund vitit 31 dhjetor 2024:

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt
I.	Aktivet e lejuara në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		3,910,330,521
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rregulluara në Republikën e Shqipërisë;	35%	9,815,000
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%	122,000,000
I.10	g) Hua të pasiguruar dhe hua të siguruar nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërinë ;	10%	182,774,748
I.11	gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gj) e Ligjit 52/14;	30%	2,006,762,591
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	1,588,978,182
II.	Investime të aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit:		-
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4:		1,842,324,096
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	105,866,477
III.5	d) Pjesën e risiguresit në provigjonet teknike, kur risiguresit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standart & Poor;	100%	54,428,204
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjionit të primit të pafituar;	20%	261,352,394
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.	5%	154,999,880
III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	53,234,828
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartanit jeshil pranë BSHS	100%	6,140,509
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	1,206,301,804
IV	TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)		5,752,654,617
V	TOTALI I INVESTIMEVE TË LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")		4,208,661,426
VI	C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)		3,973,553,878
VI.1	Provigjone të primit të pafituar		2,888,848,175
VI.2	Provigjone të dëmeve		1,084,705,703
VII	Tepricë (+) / Mungesë(-) (V-VI)		235,107,548
VIII	Mbulimi në % (V/VI)		105.92%

Albsig sh.a**SKEDULET PLOTESUESE***(Vlerat janë në Lekë)***2. MARZHI I AFTËSISË PAGUESE**

Sipas nenit 80 të ligjit 52''Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit'' niveli i kërkuar i Aftësisë Pagueuse të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370.000.000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë pagueuse. Niveli aktual i aftësisë pagueuse më 31 dhjetor 2024 është brenda limiteve të kërkuara.

Marzhi i aftësisë pagueuse duke përdorur metodën e kapitalit neto më 31 dhjetor 2024 përbëhet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	2.096.284.170
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të emetuara;	879,460,000
I.c	Fitimi i pashpërdarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	1,220,017,797
II	Elementet që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç)	3,193,628
II.b	Investimet në aktive të patrupëzuara	3,193,628
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	839,545,523
IV.a	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 përqind	432,254,000
V	Aktivet jolikuide (V.a deri V.g)	407,291,523
V.a	Aksionet e palistruara në tregje të rregulluara	
V.b	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura	182,774,748
V.c	Huatë nga brokerat dhe agjentët	
V.ç	Primet e arkëtueshme ose debitorë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90-ditor;	143,774,620
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	74,601,645
V.h	Elemente të tjerë të zbritshëm sipas nenit 4 të kësaj rregullore (V.-h-1 deri V.h-10) :	6,140,509
V.h-9	Fondi i Garancisë për Kartonin Jeshil	6,140,509
VI	KAPITALI (Aftësia Pagueuse)	1,256,738,647
VII	Kufiri minimal i aftësisë pagueuse, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	615,983,917
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë pagueuse, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	923,975,876
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë pagueuse (VI-IX)	332.762.772
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I mjaftueshëm

Albsig sh.a

SKEDULET PLOTESUESE

(Vlerat janë në Lekë)

3. KUFIRI MINIMAL I AFTËSISË PAGUESE

Sipas vendimit nr. 191 datë 25.03.2005 "Për miratimin e metodikës: Për mënyrat e llogaritjes së nivelit të kërkuar të aftësisë paguese për sigurimin e jetës dhe jo-jetës të shoqërive të sigurimit, si dhe elementët që e përbejnë atë" koeficienti i pasigurisë për llogaritjen e të ardhurave është vlera maksimale e pritshme e diferencës midis rrezikut aktual dhe rrezikut të marrë në konsideratë në llogaritje.

b1 = koeficienti i pasigurisë, duke marrë në konsideratë shumën "a" është 0.18

b2 = koeficienti i pasigurisë, i llogaritur duke marrë në konsideratë "a2" është 0.16

Sipas nenit 80 të ligjit 52 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" niveli i kërkuar i Aftësisë Paguese të Shoqërisë së Sigurimit është vlera më e lartë midis Fondit të Garancisë (370.000.000 Lekë) dhe 150 përqind të kufirit minimal të aftësisë paguese. Niveli aktual i aftësisë paguese më 31 dhjetor 2022 është brenda limiteve të kërkuara.

Niveli i kërkuar i aftësisë paguese llogaritur nga Shoqëria si dhe aftësia paguese e saj është si më poshtë:

	Kufiri minimal i Aftësisë paguese, Jo Jete	31.12.2024
1	1.Llogaritja me baze primet	
2	Prime të shkruara nga aktiviteti i sigurimeve	4,313,201,807
3	Prime të shkruara nga aktiviteti i risigurimeve	-
4	Taksa të zbritshme	208,472,647
5	Shuma "a" (5=2+3-4)	4,104,729,160
6	Pjesa e shumës "a" me e vogël se 1,000,000,000 leke (6=min(1,000,000,000,5))	1,000,000,000
7	Pjesa e shumës "a" me e madhe se 1,000,000,000 leke (7=5-6)	3,104,729,160
8	Koeficienti i pasigurisë a1 (8=0.18)	0.18
9	Koeficienti i pasigurisë a2 (9=0.16)	0.16
10	Total (10=6*8+7*9)	676,756,666
11	Deme të paguara bruto	1,275,022,313
12	Pjesa e risiguruesit në demet e paguara	141,741,948
13	Deme të paguara neto (13=11-12)	1,133,280,364
14	provigjone bruto të demeve në periudhën aktuale	1,084,010,631
15	provigjone bruto të demeve në fund të vitit të kaluar	872,309,218
16	pjesa e risiguruesve në provigjonet e demeve në periudhën aktuale	-
17	pjesa e risiguruesve në provigjonet e demeve në fund të vitit të kaluar	8,300,000
18	provigjone neto të demeve në periudhën aktuale (18=14-16)	1,084,010,631
19	provigjone neto të demeve në fund të vitit të kaluar (19=15-17)	864,009,218
20	ndryshimi në provigjonet e demeve bruto (20=14-15)	211,701,413
21	ndryshimi në provigjonet neto të demeve (21=18-19)	220,001,413
22	Deme të ndodhura bruto (22=11+20)	1,486,723,725
23	Deme të ndodhura neto (23=21+13)	1,353,281,777
24	Raporti i mbajtjes (24=max(0.5 , 23/22))	0.9102
25	Rezultati nga llogaritja me baze primet (25=24*10)	615,983,917

V

10 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE VJETORE

Misioni i Shoqërisë ALBSIG SH.A. është shërbimi cilësor në të gjithë klasat e sigurimit të jo - jetës për grupe dhe individë nëpërmjet produkteve cilësore të sigurimit, cilësisë dhe shpejtësisë së pagesës së dëmeve, stabilitetit e ruajtjes të gjendjes financiare.

Veprimtaria e shoqërisë mbështetur në ekperiencën e saj në tregun e sigurimeve jo-jetë, zhvillimeve e tregut si dhe burimeve njerëzore ka përcaktuar objektivat e mëposhtme:

- Pagesa shumë e shpejtë e dëmeve;
- Ruajtja e standarteve të larta në përzgjedhjen e personelit që merret me marrjen në sigurim, shitjen dhe e ndërmjetësive në sigurime;
- Rritja dhe mbulimi i provigjioneve teknike me burime të mjaftueshme financiare, diktuar nga:
 - Zgjerimi i gamës së produkteve;
 - Impulset pozitive të rritjes në tërësi të të ardhurave nga linjat e sigurimit vullnetar.
- Perfeksionimi në vazhdim i linjave të biznesit nëpërmjet implementimit të skemave sa më optimale të shërbimit informatik, etj.
- Cilësia e shërbimit të drejtpërdrejtë ndaj klientit e shprehur me një proces efektiv dhe cilësor të marrjes në sigurim dhe me pagesën e shpejtë dhe cilësore të dëmeve të shprehur me nivelin e pagesave dhe provigjonimin real të dëmeve, që përfundimisht do të çojnë në raporte dëme / prime ndjeshëm më të larta se aktualet e tregut.
- Lidhja e marrëveshjeve dhe kontratave efektive të risigurimeve me risigurues seriozë në funksion të rritjes së kapacitetit mbajtës dhe ruajtjes së stabilitetit financiar të shoqërisë.
- Hartimi dhe vënia në funksion e një programi fleksibël dhe efektiv për rekrutimin, motivimin dhe rritjen cilësore të burimeve njerëzore të shoqërisë duke sjellë një rritje të konsiderueshme të stafit të shoqërisë.

Këto objektiva strategjike do të ndihmojnë në përcaktimin e një vizioni të qartë dhe në zhvillimin e rekomandimeve për të përmirësuar shoqërinë Albsig sh.a. në të ardhmen.

- **Analiza e Tregut dhe Identifikimi i Mundësive të Rritjes:** Studimi i përqindjes së tregut për çdo segment të sigurimeve dhe identifikimi i sektorëve potencialë për rritje.
- **Inovacioni dhe Përdorimi i Teknologjisë:** Identifikimi i inovacioneve të fundit dhe përdorimi i teknologjisë për të përmirësuar përvojën e klientit, si dhe efikasitetin operacional të Albsig sh.a.. Analiza e avantazheve dhe sfidave të përdorimit të teknologjisë në sektorin e sigurimeve në Shqipëri.
- **Përmirësimi i Performancës Financiare:** Vlerësimi i performancës financiare të Albsig sh.a. duke përfshirë analizën e rritjes së fitimit, efikasitetit të kostove dhe menaxhimit të rrezikut financiar. Identifikimi i strategjive për të përmirësuar performancën financiare dhe stabilitetin e shoqërisë Albsig sh.a. në treg.
- **Zhvillimi i Produktit dhe Diversifikimi:** Zhvillimi i produkteve të reja të sigurimeve që përputhen me nevojat e klientit të ndryshuar dhe tendencat e tregut. Identifikimi i mundësive për diversifikim të ofertës së produkteve dhe analiza e rrezikut të lidhur me zgjerimin e portofolit të produkteve.
- **Përqasja ndaj Sfidave dhe Rrjedhës së Rregullatorëve:** Përcaktimi i sfidave kryesore dhe ndikimit të rregullatorëve në tregun e sigurimeve në Shqipëri. Analiza e rregullimeve të reja dhe strategjitë për t'u përshtatur me ndryshimet në mjedisin rregullator.

Këto objektiva strategjike do të ndihmojnë në përmirësimin e analizës dhe raportimit në raportin vjetor për sektorin e sigurimeve në Shqipëri, duke siguruar një vizion të qartë strategjik dhe rekomandime për të ardhmen e tregut të sigurimeve.



PJESË E  KASTRATI GROUP



info@albsig.al
www.albsig.al

+355 (0) 44502060 / +355 (0) 42254770

ALBSIG sh.a.
Bulevardi Bajram Curri, Albsig HQ, Kati 16&17,
1010 – Tirana, Albania